



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 9 regjistër (JR)  
Datë 02.03.2021

Nr. 42 i vendimit  
Datë 06.10.2023

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 9/2021 (JR), datë 02.03.2021, zhvilloi bisedimet përfundimtare në dhomë këshillimi dhe mori vendimin lidhur me këtë çështje në datën 03.10.2023, në prezencë të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova. Më datë 06.10.2023, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të së njëjtës vëzhguese ndërkombëtare, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, e shpalli publikisht vendimin lidhur me këtë çështje, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 319, datë 03.12.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Kujtim Luli.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në datat 25.07.2023, 18.09.2023 e 26.09.2023, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 319, datë 03.12.2020, për subjektin e rivlerësimit Kujtim Luli dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Kujtim Luli, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Kujtim Luli ka ushtruar detyrën e prokurorit prej vitit 1994 e në vijim dhe në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ai ushtronte këtë detyrë në Prokurorinë e Përgjithshme. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, subjekti iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor<sup>1</sup>, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë<sup>2</sup>, deklaratën për kontrollin e figurës<sup>3</sup>, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional<sup>4</sup>.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite.*
  - (ii) *Ka mungesë dokumentacioni justifikues për burimin e krijimit të pasurive.*
  - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
  - (iv) *Nuk ka kryer deklarim të rremë.*

<sup>1</sup>Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

<sup>2</sup>Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 27.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.01.2017. Deklarata e pasurisë mban datën 26.01.2017.

<sup>3</sup> Referuar raportit të Grupit të Punës me nr. {\*\*\*}, datë 30.10.2017, të deklasifikuar plotësisht, formulari i vetëdeklarimit rezulton të jetë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016 dhe mban datën 28.01.2017.

<sup>4</sup>Referuar raportit nr. {\*\*\*} prot., datë 11.10.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, subjekti i rivlerësimit rezulton ta ketë dorëzuar këtë të fundit më datë 30.01.2017.

*(v) Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Në raportin e saj, DSIK-ja konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë, të plotë dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, dhe se lidhur me të nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Grupi i punës, konstatoi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Kujtim Sh. Luli.
5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin në fjalë, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 318, datë 03.12.2020.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

7. Me vendimin nr. 318, datë 03.12.2020, me shumicë votash, Komisioni vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Ky vendim është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

*7.1 Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.*

*7.2 Në lidhje me kontrollin e figurës, referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Kujtim Luli, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

*7.3 Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, pas propozimit të relatores, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.*

8. Me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 22.09.2021, të depozituar në Kolegj në datën 23.09.2021, është njoftuar vendimi i Komisionit, datë 16.09.2021, “Korrigjim vendimi”. Nëpërmjet këtyre akteve, është korrigjuar numri që kishte marrë vendimi, nga “nr. 318” në “nr. 319”.

### **III. Shkaqet e ankimit**

9. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, më datë 24.02.2021, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 319<sup>5</sup>, datë 03.12.2020. Komisioneri Publik pretendon se në vendimin objekt ankimi evidentohen si shkaqe për gjykim rrethana dhe fakte ligjore, lidhur me: (i) deklarin e pasaktë dhe të pamjaftueshëm të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, mbi shpenzimet e shkollimit të djemve të tij në ShBA; (ii) pamjaftueshmërinë financiare të burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për përbalimin e shpenzimeve; (iii) deklarin e pasaktë dhe të pamjaftueshëm të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për pasurinë në formën e likuiditeteve *cash* ndër vite; si dhe (iv) përfitimin nga subjekti i rivlerësimit të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti për blerjen e pasurisë apartament me sip. 105,1 m<sup>2</sup>, në Tiranë, jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.
10. Po ashtu, Komisioneri Publik kundërshtoi vendimin e Komisionit pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke bërë të aplikueshëm nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, nenin 33, pika 5, gjerat “a” dhe “b” dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Sipas Komisionerit Publik, këto aspekte, sikurse edhe fakti që subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredi me kushte lehtësuese nga shteti jashtë kriterëve të përcaktuara ligjore, në një vlerësim tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, mund të vlerësohet se çon në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, referuar nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
11. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik, bazuar në nenet Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, nenet 4, 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë *ndryshimin* e vendimit nr. 319, datë 03.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe *shkarkimin* nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

---

<sup>5</sup> Referuar sipas numrit të ndryshuar me vendimin e Komisionit, datë 16.09.2021, “Korrigjim vendimi”.

12.1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me *shpenzimet e shkollimit* të dy djemve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

12.2 Lidhur me pasurinë e paluajtshme apartament<sup>6</sup>: (i) subjekti ka përdorur në kundërshtim me kriteret e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102/1999<sup>7</sup>, kredinë në vlerën e 5.000.000 lekëve, përftuar me kushte lehtësuese nga shteti; (ii) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, referuar nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

##### a) Juridiksioni i Kolegjit

13. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Kujtim Luli, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### b) Legjitimimi i ankuesit

14. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>8</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

##### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

15. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ankimi kundër vendimit të Komisionit i ushtruar nga Komisioneri Publik, shqyrtohet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt

---

<sup>6</sup> Me sipërfaqe 105,1 m<sup>2</sup> në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë.

<sup>7</sup> “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

<sup>8</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 319, datë 30.12.2020, për rivlerësimin e subjektit Kujtim Luli, i është njoftuar Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 09.02.2021, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., të datës 10.02.2021, konfirmuar sipas lajmërimarrjes së nënshkruar nga F. J., kurse ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 24.02.2021, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 24.02.2021, që rezultoi të jetë dita e 14-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

gjykimi, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve.

16. Në fazën procedurale të kërkesave paraprake, subjekti i rivlerësimit ngriti pretendime: (i) për *pavlefshmëri absolute* të vendimit nr. 93/1, datë 24.02.2021, të Komisionerit Publik Dariel Sina për mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e Komisionerit Publik Florian Ballhysa; dhe (ii) për *pavlefshmëri absolute* të ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 318/319, datë 03.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Kujtim Luli, duke kërkuar nga trupi gjykues konstatimin e pavlefshmërisë së këtyre dy vendimeve, si dhe rrjedhimisht mospranimin e ankimit, i cili, sipas tij, nuk plotësonte kushtet e pranueshmërisë për shqyrtim ose pushimin e gjykimit të çështjes.

16.1. Kërkesa në fjalë mbështetej në pretendimin se procedura e shqyrtimit të vendimit të Komisionit nga ana e Institucionit të Komisionerëve Publikë, është zhvilluar në shkelje të procesit të rregullt ligjor, duke qenë se ky institucion ka cenuar parimet e kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, proporcionalitetit, barazisë para ligjit, drejtësisë dhe paanësisë, diskrecionit, përgjegjshmërisë, vendimmarrjes dhe mosdiskriminimit, me pasojë pavlefshmërinë absolute të akteve të nxjerra nga Institucioni i Komisionerëve Publikë.

16.2. Në kërkesën e tij para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit pretendoi se faktet e parashtruara lidhur me një çështje penale në gjykim nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vitin 2011, ku subjekti i rivlerësimit kishte marrë pjesë në cilësinë e prokurorit që përfaqësonte organin e akuzës, ndërsa Komisioneri Publik ishte përfshirë në cilësinë e këshilltarit ligjor të asaj gjykate, përbënin arsye serioze për njëanshmëri dhe mungesë garancie për paanësi, referuar nenit 27, pika 1 e vijues të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me nenin 30, shkronja “g” e Kodit të Procedurave Administrative. Për këto shkaqe, në datën 22.02.2021, subjekti i rivlerësimit kishte depozituar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, kërkesën me objekt “Kërkesë për heqjen dorë ose përjashtimin e Komisionerit Publik, z. Florian Ballhysa, për të garantuar paanësi në procedurën administrative në shqyrtim për subjektin e rivlerësimit”.

16.3. Për sa më sipër, subjekti pretendoi se Komisioneri Publik ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, duke sjellë për pasojë edhe pavlefshmërinë absolute të ankimit të ushtruar prej tij, bazuar në parashikimin e nenit 108, shkronja “b” e Kodit të Procedurave Administrative, e cila parashikon se akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm kur është nxjerrë në kushtet e konfliktit të interesit.

16.4. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se vendimi [nr. 93/1, datë 24.02.2021] me anë të të cilit Komisioneri Publik Darjel Sina kishte vendosur për mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e Komisionerit Publik Florian Ballhysa nga shqyrtimi i vendimit objekt ankimi i Komisionit, ishte absolutisht i pavlefshëm, duke qenë se: (i) Komisioneri Publik Darjel Sina nuk ishte organi kompetent sipas ligjit për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për kushtet e konfliktit të interesit; (ii) akti i nxjerrë nga Komisioneri Publik Darjel Sina është i paarsyetuar, pasi në përmbajtjen e tij nuk ishte parashtruar kërkesa e subjektit të rivlerësimit dhe rrethanat e faktit apo arsyetimi ligjor mbi të cilin bazohej ajo, gjë që përbën

njëanshmëri në vendimmarrjen e Komisionerit Publik; (iii) vendimi nr. 93/1, datë 24.02.2021, i Komisionerit Publik Dariel Sina është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e përcaktuar sipas nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me nenet 30, 31 e 32 të Kodit të Procedurës Administrative, pasi z. Sina nuk ka qenë as titullari i Institucionit të Komisionerëve Publikë, e as trup gjykues që të mund të shqyrtonte kërkesën e subjektit të rivlerësimit.

**16.5.** Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi kërkesën paraprake të subjektit të rivlerësimit dhe aktet shkresore të paraqitura në mbështetje të saj, me vendim të ndërmjetëm vendosi rrezimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për të tria kërkimet, si të pabazuara në fakte dhe në ligj. Trupi gjykues vëren pikësëpari se bazuar në parashikimet e Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, Institucioni i Komisionerëve Publikë është njëri prej tri institucioneve kushtetuese të rivlerësimit. Ky institucion përbëhet nga dy komisionerë publikë me kompetenca të njëjta, të plota dhe të pavarura në ushtrimin e funksionit kushtetues të përfaqësimit të interesit publik në procesin e rivlerësimit kalimtar, nëpërmjet ushtrimit të ankimit ndaj vendimeve të Komisionit. Thënë kjo, referuar parashikimeve kushtetuese dhe ligjore në fuqi, komisionerët publikë nuk janë në varësi të asnjë institucioni tjetër “epror” dhe as i ushtrojnë funksionet dhe kompetencat e tyre të organizuar në “trupa gjykues”. Interpretimi i ngushtë e literal i nenit 27, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashtruar nga subjekti, sipas të cilit përjashtimi i Komisionerit Publik nga shqyrtimi i një çështjeje do duhej të vendosej nga një tjetër *trup gjykues*, do të sillte si pasojë pamundësinë e shqyrtimit të kërkesave të tilla, duke cenuar për rrjedhojë, jo vetëm të drejtat e subjekteve të rivlerësimit, por edhe interesin e publikut në mbarëvajtjen e këtij procesi. Në këtë kuptim, trupi gjykues e gjen procedurën e ndjekur nga Institucioni i Komisionerëve Publikë të drejtë dhe në përputhje me parimet kushtetuese, referuar edhe rregullimeve të brendshme të këtij institucioni<sup>9</sup>, për mënyrën e shqyrtimit të kërkesave për heqje dorë/përjashtim të Komisionerit Publik nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit.

**16.6.** Për rrjedhojë, trupi gjykues konkludon se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje të ligjit për shkak të procedurës së ndjekur nga Komisioneri Publik Dariel Sina në marrjen e vendimit nr. 93/1, datë 24.02.2021, e që lidhet me kërkesën e tij për heqjen dorë ose përjashtimin e Komisionerit Publik Florian Ballhysa, nuk bazohen as në fakte e as në ligj. Bazuar në analizën e mësipërme, trupi gjykues arriti në të njëjtin konkluzion për pretendim të pabazuar në fakte e në ligj edhe për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se vendimi i sipërcituar është nxjerrë nga një organ jokompetent.

**16.7.** Edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pavlefshmëri absolute të vendimit për mospranim të kërkesës për përjashtim të Komisionerit Publik Florian Ballhysa si i paarsyetuar, u vlerësuan të pabazuara pas analizës së kryer nga trupi gjykues i Kolegjit. Nga përmbajtja e tij, rezulton se vendimi përmban faktet thelbësore mbi bazën e të cilave subjekti ka parashtruar një kërkesë përpara Institucionit të Komisionerëve Publikë, bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur Komisioneri Publik në marrjen e këtij vendimi, sikundër dhe shkaqet për të cilat ka

<sup>9</sup> Shih: <https://ikp.al/wp-content/uploads/2018/11/1.Rregullorja-%E2%80%99CP%C3%ABr-Veprimtarin%C3%ABe-Institucionit-t%C3%AB-Komisioner%C3%ABve-Publik%C3%AB%E2%80%9D.pdf>.

vlerësuar marrjen e vendimit të paraqitur qartë në dispozitivin e tij. Ndonëse akti nuk karakterizohet nga një arsyetim i hollësishëm, dhe në të nuk përcaktohet detyrimi për t'ia njoftuar subjektit të rivlerësimit, siç me të drejtë ka pretenduar ky i fundit në kërkesën para Kolegjit, trupi gjykues çmoi se sa më sipër, nuk mund të argumentohen se ngrihen në nivelin e problematikave të përcaktuara nga neni 108, shkronja “a” (iii) e Kodit të Procedurave Administrative, me pasojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ objekt shqyrtimi.

**16.8** Trupi gjykues i Kolegjit çmoi se është i pabazuar në fakte dhe në ligj pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioneri Publik Florian Ballhysa ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit me pjesëmarrjen e tij në procedurën administrative të shqyrtimit të vendimit të Komisionit nr. 318/319, datë 03.12.2020, që i përkiste subjektit të rivlerësimit. Për pasojë, edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit për pavlefshmërinë absolute të ankimit të ushtruar nga ky komisioner publik, është i pabazuar. Në arritjen e këtij përfundimi, trupi gjykues mbajti në konsideratë që rrethanat e parashtruara që lidhen me një procedim penal të vitit 2011, në një çështje penale të shqyrtuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, 10 vite përpara se të ushtrohej ankimi kundër vendimit që konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit, janë ngushtësisht të lidhura me ushtrimin e detyrave të secilës palë, në përmbushje të detyrës funksionale që kryenin në atë periudhë kohore. Për pasojë, rrethanat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit nuk mund të argumentohen edhe teorikisht si rrethana që përbëjnë arsye serioze për njëanshmëri të Komisionerit Publik në kuptim të nenit 30, shkronja “g” e Kodit të Procedurave Administrative, në çfarëdo aspekti të analizohen. Po ashtu, në kushtet që konflikti i interesit kushtëzohet tërësisht nga tagrat vendimmarrëse – të cilat z. Ballhysa nuk i gëzonte si këshilltar ligjor në vitin 2011 – pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar edhe nën dritën e dispozitave të ligjit nr. 9367/2005 që normon kushtet për parandalimin e konfliktit të interesit të funksionarëve publikë. Në këto kushte, edhe sipas testit objektiv referuar standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shqetësimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me cenimin e parimit të paanësisë, si pasojë e rrethanave të faktit të parashtruara në kërkesën e tij, nuk mund të justifikohet në mënyrë objektive.

17. Në vijim, në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit drejtuar trupit gjykues për marrjen në cilësinë e provave të akteve shkresore të depozituara së bashku me parashtrimet e tij gjatë gjykimit të çështjes në Kolegji dhe, për rrjedhojë, riçeljen pjesërisht të hetimit gjyqësor, trupi gjykues, pasi dëgjoi edhe Komisionerin Publik lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm<sup>10</sup>, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, vendosi riçeljen e hetimit gjyqësor dhe marrjen në cilësinë e provës të akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

**B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

18. *Deklarimi i pasaktë dhe i pamjaftueshëm lidhur me shpenzimet e shkollimit të dy fëmijëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës*

---

<sup>10</sup> Shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 18.09.2023.



**18.1.** Komisioni ka arritur në konkluzionin se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë bindëse në lidhje me pasaktësitë e konstatuara dhe se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të shkollimit të dy fëmijëve të subjektit të rivlerësimit jashtë vendit. Komisioni ka arsyetuar për secilin aspekt shpenzimesh se:

(i) Për shpenzimet e shkollimit të K. L. [në Massachusetts, ShBA], për periudhën gusht 2009 – maj 2013, subjekti ka deklaruar *me vërtetësi dhe saktësi tarifave* e shkollimit dhe ka treguar kujdesin e shtuar për të depozituar faturat e lëshuara nga universiteti dhe pagesat që ka kryer nëpërmjet transfertave bankare nga Shqipëria. Komisioni ka vlerësuar pozitivisht faktin që faturat e disponuara nga subjekti janë të detajuara.

(ii) Për pagesën për shkollimin e djalit tjetër, E. L., në shkollën e mesme [{"\*\*\*"}], Prizren, Kosovë], për periudhën gusht 2009 – qershor 2011, shpenzimet e kryera u përlllogaritën në vlerën totale prej 5.400 eurosh (tarifa për konviktore 2.640 + 2.760). Një diferencë prej 80 eurosh u konsiderua gabim i papërfillshëm në deklarinin e shpenzimeve nga subjekti.

(iii) Në lidhje me pagesën e studimeve universitare [në dy universitete në Massachusetts, ShBA] për djalin E. L., gjatë periudhës gusht 2013 – maj 2015, dhe më pas në 2015 – maj 2017, Komisioni pranoi si bindës shpjegimin e subjektit për diferencën e vlerave të deklaruara në deklaratën *vetting* dhe kundrejt sa rezulton nga deklarinimet periodike në vitet 2013 – 2017. Një diferencë e konstatuar nga Komisioni, u vlerësua pasojë e mospërfshirjes së pagesës së janarit të vitit 2017, në shumën e deklaruar në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, për mungesë informacioni nga personi i lidhur. Komisioni vendosi të përfshijë edhe të ardhurat e djalit K. L. në investimet për shkollimin e vëllait të tij, si dhe vlerësoi si bindëse provat dhe shpjegimin e subjektit për diferencën e konstatuar e nuk përfshiu në analizën financiare një shumë shpenzimesh prej 9.378 USD në shpenzimet e shkollimit të djalit tjetër [E. L.]

**18.2.** Komisioneri Publik e kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e mësipërm të Komisionit, duke ngritur pretendime në drejtim të saktësisë së deklarinimit të vlerës së shpenzimeve të kryera, si dhe të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për përballimin e tyre. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të shpenzimeve të shkollimit të dy djemve të tij. Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar dhe nuk ka vërtetuar me dokumentacion të plotë ligjor shpenzimet e jetesës së dy djemve gjatë shkollimit të tyre jashtë vendit. Duke referuar në ankim edhe arsyetimin e Kolegjit në paragrafët 76-79 të vendimit JR nr. 19/2019<sup>11</sup>, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarinimit të pasaktë, referuar parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Në mbështetje të sa më sipër, Komisioneri Publik parashitroi konstatimet dhe pretendimet e mëposhtme.

**18.3.** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore dhe deklaratën *vetting*, vetëm pagesat e kryera për llogari të universiteteve private në ShBA, ndërsa gjatë hetimit

---

<sup>11</sup> Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Xh. Zaganjori, në: [https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh\\_Zaganjori-i-anonizuar-perfshire-mendimin-parallel.pdf](https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh_Zaganjori-i-anonizuar-perfshire-mendimin-parallel.pdf).

administrativ<sup>12</sup> ka deklaruar edhe shpenzime *shtesë*, të cilësuar nga vetë ai si shpenzime për jetesë etj., në shumat 4.000 USD/vit të plotë dhe 2.000 USD për një semestër shkollor<sup>13</sup> për secilin prej tyre, të pashoqëruara me dokumentacion ligjor justifikues.

**18.4.** Komisioneri Publik konstatoi se referuar akteve të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit mbi shpenzimet e fëmijëve për vitet 2009 – 2016, duket se për periudhën gusht 2009 – maj 2011 (viti i parë dhe i dytë i shkollimit të djalit K.L.), shumat e paguara për llogari të universitetit, përveç tarifave të shkollimit, përfshijnë dhe shpenzimet e jetesës në kampusin universitar (dhomë, sigurim shëndetësor, ushqim dhe libra), ndërsa për periudhën gusht 2011 e në vijim (për djalin K. L. dhe nga viti 2013 e në vijim për djalin E. L.)<sup>14</sup>, duket se dokumentacioni i sjellë provon vetëm pagesat e tarifave të shkollimit dhe nuk provon mbulimin e shpenzimeve të ushqimit, shpenzimet për libra, transport dhe pagesa të tjera që nevojiten për jetesën e një studenti<sup>15</sup>.

**18.5.** Komisioneri Publik potencon se përveçse deklarative dhe të pashoqëruara nga ndonjë dokumentacion ligjor justifikues, shpenzimet shtesë si më sipër referuar, nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore, pavarësisht prej detyrimit që rrjedh për subjektin e rivlerësimit nga neni 2/7 i ligjit nr. 9049/2003<sup>16</sup>, sipas të cilit: *shpenzim i deklarueshëm është tërësia monetare e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues*. Po sipas Komisionerit Publik, referuar nenit 4, germa “h” e këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për deklarimin e pasurive dhe shpenzimeve të kryera përtej vlerës 500.000 lekë përpara vitit 2014 (2012 – 2014), dhe 300.000 lekë pas këtij viti.

**18.6.** Në parashtrimet e tij në seancë publike në Kolegj, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi pretendimin e Komisionerit Publik si të pabazuar në ligjin e zbatueshëm dhe në rrethanat e faktit të provuara nga hetimi administrativ i Komisionit. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi në mënyrë të përmbledhur se:

(i) Rubrika “Shpenzimet e deklarueshme”, e shtuar në deklaratën periodike të vitit 2012 e në vijim, nuk parashikonte deklarimin e burimit të origjinës së pagesave/shpenzimeve, por vetëm përshkrimin e shpenzimit (përfshirë arsimimin) apo detyrimin financiar. Në procesverbalin e datës 18.03.2016, gjatë procedurës së kontrollit të deklarimit të pasurisë për periudhën 2003 – 2014 në ILDKPKI, si dhe në “Shpjegimet shtesë”, datë 28.03.2016, pranë të njëjtit institucion, sikundër dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, ka vetëdeklaruar të gjitha shpenzimet për shkollimin e dy djemve në Kosovë dhe në ShBA, si dhe burimin e shpenzimeve të kryera për

<sup>12</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, datë 3.7.2019.

<sup>13</sup> Rezulton se 2 vitet e para, djali K. L. ka qëndruar në kampus dhe fatura e paguar nga subjekti i rivlerësimit ka në kostot e parashikuara dhe kostot e qëndrimit, ushqimit dhe pagesës së librave.

<sup>14</sup> Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti nga {\*\*\*} ({\*\*\*}), {\*\*\*} dhe {\*\*\*} mbi detajet e pagesave.

<sup>15</sup> Gjatë hetimit administrativ, në pyetësorin nr. 8, subjekti i rivlerësimit deklaroi se fëmijët jetojnë në banesë me qira, duke filluar nga muaji gusht 2011 e në vijim, shpenzime të cilat janë përfshirë në analizën financiare të viteve respektive.

<sup>16</sup> “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, me ndryshimet përkatëse.

shkollimin e tyre. Po sipas subjektit të rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, hartuar në datën 26 janar 2017, si dhe në deklaratat periodike të viteve 2014 – 2017, për pagesat/shpenzimet për shkollimin e djalit E. L., ka deklaruar edhe burimin e origjinës së pagesës familjare. Shuma totale e pagesave përputhet me dokumentacionin e administruar nga universitetet përkatëse për secilin nga djemtë.

(ii) Diferencat në vlera jo të konsiderueshme në shifrat e deklaruara për shkollimin e djalit K.L., janë të lidhura me komisionet e disa transfertave bankare, një tarifë rinovimi e siguracionit mjekësor dhe kostoja e klasës së fundit të shkollës, e pashoqëruar me faturën përkatëse të {\*\*\*}, të paguara nga djali me transferata *cash/elektronik* nga të ardhurat nga puna në kampusin e shkollës, për të cilat subjekti nuk ka qenë i përditësuar në periudhat përkatëse të deklarimit apo shpjegimeve të dhëna.

(iii) Gjithashtu, diferencat në raport me shifrat e deklaruara për shkollimin e djalit E. L., nuk kanë të bëjnë me vlera/pagesa të padeklaruara, por lidhen me faktin e mospërputhjes në kohë të informacionit të plotë mbi pagesat e kryera në janar 2017 (nga djali K. L.) për shkollimin e djalit (E. L.), me momentin e deklarimeve të kryera për procesin e *vetting*-ut, si dhe nga leximi jo i saktë i zërave/elementeve të përshkruara në “Raportin përmbledhës” të {\*\*\*}.

(iv) Pretendimi i Komisionerit Publik për deklarim të pasaktë dhe të pashoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues të shpenzimeve të jetesës së djemve, është i pabazuar në nenin 2, pika 7 dhe në nenin 4, shkronja “h” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar me ligjin nr. 85/2012, si dhe me faktet e vërtetuara bazuar në provat e administruara nga hetimi administrativ në Komision. Shpenzimet e jetesës dhe të udhëtimit në shumat 4.000 USD dhe 2.000 USD, që nuk janë pjesë e faturës së shkollës, të dhëna *cash*, janë vetëdeklaruar në “Shpjegimet shtesë”, datë 28.03.2016, në ILDKPKI, të administruara në Komision. Nëpërmjet këtyre shumave në *cash*, janë përballuar kostot e jetesës/ushqimit, biletat e udhëtimit dhe akomodimit pas vitit akademik 2011 – 2012 e në vazhdim. Ato nuk janë deklaruar në deklaratat periodike të viteve përkatëse, nisur nga natyra e tyre – me lloje/zëra të ndryshëm – që nuk kapërcejnë vlerën vjetore 5.000 USD ose ndryshuar në 500.000 lekë, e parashikuar në shkronjën “h” të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar me ligjin 85/2012, hyrë në fuqi më datë 26.10.2012. Ndryshe nga vetëdeklarimet e tij në ILDKPKI më 28.03.2016, me shumën 4.000 USD janë përballuar kostot e jetesës/ushqimit, biletat e udhëtimit dhe pjesërisht akomodimi. Në analizën financiare të KPK-së, vlera/shuma përkatëse është trajtuar vetëm për jetesë/ushqim, pa përfshirë shpenzimet e udhëtimit dhe pjesërisht akomodimit. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji që rezultatet e aktit të ekspertimit ekonomiko-financiar, datë 10.12.2022, të depozituar prej tij në Kolegj në cilësinë e provës, së bashku me parashtrimet, të vlerësohen e të pranohen sipas “Shpjegimeve shtesë”, datë 28.03.2016, në ILDKPKI dhe jurisprudencës së Kolegjit në vendimin e tij nr. 37/2021.

**18.7.** Pasi analizoi aktet e fashikullit të çështjes, pretendimet e Komisionerit Publik dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar. Situata faktike e pretenduar nga Komisioneri Publik për sa u përket shpenzimeve të jetesës, deklaruar për dy

fëmijët e subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës së shkollimit të tyre në harkun kohor të viteve 2011 – 2016, rezulton qartë edhe nga përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në pyetësonin standard të Komisionit të datës 03.12.2019, sikurse edhe në përgjigjet e dhëna lidhur me pyetësonin e Komisionit të datës 18.03.2020, si dhe në përgjigjet e dhëna lidhur me kërkesën e Komisionit për shpjegime, të datës 21 korrik 2020. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit u vlerësuan të pabazuara. Arsyetimi mbi të cilin mbështetet ky konkluzion i trupit gjykues, shtjellohet në vijim.

**18.8.** Pikësëpari, nga aktet në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje se në total, shpenzimet për *shkollimin* e fëmijëve në vitet 2009 – 2017, janë në vlerën 178.657 USD dhe 5.400 euro. Pasi pranoi shpjegimet e subjektit, vlera e pranuar dhe e përllogaritur nga Komisioni, është 168.150 USD dhe 5.400 euro. Në këtë vlerë të dytë, Komisioni vlerësoi bindëse pretendimet e subjektit për diferencën për shkak shpenzimesh të tjera administrative [për djalin e madh] apo gabimeve të kryera në mbifaturimin e kryer nga shkolla për djalin e vogël. Komisioni ka konstatuar edhe diferenca në vlerat përkatëse të shpenzimeve, sipas deklaratave periodike vjetore, përkundër deklaratës së pasurisë *vetting* dhe në pyetësonorë.

a. Konkretisht, Komisionit i ka rezultuar se për shkollimin e djalit K. L. [në vijim “djali i madh”], në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar shumën në total prej 72.479 USD. Nga analiza e deklaratave periodike vjetore, rezulton e deklaruar shuma prej 72.587 USD, ndërsa nga transfertat dhe gjatë hetimit administrativ, vlera është evidentuar në 77.330 USD. Këto shpenzime i përkasin harkut kohor 2009 – 2013.

b. Për sa i përket shkollimit të djalit tjetër [E. L., në vijim “djali i vogël”], në deklaratën *vetting* subjekti ka deklaruar të shpenzuar vlerën 76.939 USD. Nga analiza e deklaratave periodike vjetore, rezulton shpenzimi i deklaruar në vlerën 90.820 USD, ndërsa sipas transfertave bankare dhe konfirmimit të universiteteve, kanë rezultuar shpenzime në vlerën 101.327 USD. Këto shpenzime i përkasin harkut kohor 2013 – 2017 dhe janë përpos shpenzimit të konfirmuar për shkollën e mesme private, në vlerën 5.400 euro, në harkun kohor 2009 – 2013.

**18.9** Komisioni rezulton të ketë pranuar shpjegimet e subjektit dhe përllogariti shpenzimet sipas deklaratave periodike vjetore. Po ashtu, Komisioni pranoi shpjegimet e subjektit se për tri vlera nga 4.000 USD secila, në periudhën kohore nga maji 2013 deri në gusht 2014, fondet janë kontribut i djalit të madh të subjektit, në favor të djalit të vogël të tij. Po ashtu, Komisioni ka pranuar pretendimet subjektit në prapësim të rezultateve të hetimit dhe ka zbritur vlerën prej 9.378 USD nga pagesa e shkollimit, meqenëse administrata e shkollës ka evidentuar me ngjyrë të verdhë pagesat e kryera për shkollim, ndër të cilat nuk bënte pjesë kjo vlerë<sup>17</sup>.

**18.10** Në datën 12.07.2019, në përgjigjet e dhëna lidhur me pyetësonin standard të Komisionit, për sa u përket *shpenzimeve* të shtatë viteve të fundit [2011 – 2017], subjekti është shprehur se shpenzimet janë ato të treguara në faturat përkatëse sipas viteve, ndërsa shpenzimet e kostos së jetesës janë të përfaqësuara, për natyrën dhe llojet e tyre të ndryshme, por pa e shoqëruar këtë

---

<sup>17</sup> Arsytuar në përmbajtje të paragrafit 8.5. të vendimit të Komisionit.

shpjegim me dokumentacion. Në vijim të këtij shpjegimi, subjekti ka referuar një tabelë me një vlerë prej “4000”, pa specifikuar monedhën, për vitet 2011 dhe 2012 dhe vlerën “2000”, po ashtu pa specifikuar monedhën, për periudhën janar – mars 2013. Për djalin e vogël, pyetur për shpenzimet e jetesës, po ashtu për shtatë vitet e fundit, subjekti ka dhënë të njëjtin shpjegim, pa e mbështetur në dokumentacion dhe referuar një tabelë në të cilën ka deklaruar në zërin *Pagesa për jetesë etj.*, vlerën “2000” për periudhat gusht – dhjetor 2013 dhe janar – maj 2017 dhe vlerën “4000” për vitet 2014 dhe 2015, sërish pa specifikuar monedhën.

**18.11** Në pyetësin e datës 18.03.2020, në vijim të kërkesës së Komisionit për të plotësuar tabelën e përfshirë në pyetësor për shpenzimet e *shkollimit të fëmijëve* për secilin vit kalendarik, sikurse edhe *kontributin* e djalit të madh me të ardhurat e tij për djalin e vogël, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar tabelën në këtë mënyrë: (i) në lidhje me shkollimin e djalit të madh, në zërin *Shpenzime jetese/udhëtimi USA*, përkatësisht për vitet 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, vlerat 2000, 4000, 4000, 4000 dhe 2000; (ii) në lidhje me shkollimin e djalit të vogël, për të njëjtën rubrikë [“Shpenzime jetese/udhëtimi në USA”], për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, përkatësisht vlerat 2000, 4000, 4000 dhe 4000. Sërish, nuk ka deklarim të monedhës. Në kushtet që shpenzimet janë kryer në ShBA, mund të prezumohet që flitet për monedhën USD.

**18.12** Në sqarimin e vlerave të deklaruara në tabelë, subjekti i rivlerësimit është shprehur sërish se shpenzimet e jetesës [...] janë të përafërta dhe për natyrën e tyre me lloje/zëra të ndryshëm, si dhe për veçoritë dhe mënyrën e jetesës [...] së djemve së bashku dhe që djali i madh ka mbuluar këto shpenzime, duke qenë i punësuar që në mars 2013, mënyrë jetese e tyre e njëzuar me jetesën në familje dhe në ShBA.

**18.13** Më tej, në shpjegimet e dhëna më datë 21 korrik 2020, subjekti ka deklaruar se në periudhën gusht 2011 – maj 2013, djali i madh ka ndarë qiranë me bashkëqiramarrës të tjerë në qytetin ku studiointe dhe që pjesa e shpenzimeve takuese të qirasë, në vlerën 350 \$/muaj, është përballuar me “të ardhurat e pagës sime dhe të bashkëshortes”, “brenda kostos së shpenzimeve të akomodimit të deklaruara”, si dhe me të ardhurat e djalit nga puna në kampusin e {\*\*\*} dhe në intership gjatë asaj periudhe. Në vijim, subjekti ka deklaruar se djali i madh ka qenë në marrëdhënie pune në periudhën qershor 2013 – dhjetor 2016, ndërsa djali i vogël ka filluar studimet në shtator 2013 [në {\*\*\*}, Massachusetts, ShBA]. Gjatë kësaj kohe, djemtë kanë jetuar bashkë me qira në një dhomë në apartamentin me bashkëqiramarrës të tjerë, në Boston [ShBA]. Shpenzimet për akomodim, në vlerën 900 \$/muaj, gjatë kësaj periudhe janë paguar nga djali i madh, me të ardhurat e tij nga puna e filluar në mars 2013 e vijim në kompaninë në të cilën ishte punësuar.

**18.14** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se gjatë viteve në të cilat janë shkolluar dy djemtë në ShBA, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore vetëm shpenzimet që u takojnë tarifave të shkollimit sipas dokumentacionit përkatës justifikues. Pretendimi i Komisionerit Publik është i drejtë, pasi subjekti nuk ka deklaruar ndër vite shpenzimet e tjera që shoqërojnë jetesën e djemve gjatë viteve të shkollimit. Nga ky konstatim, bën përjashtim vetëm periudha gusht 2009 – maj 2011, gjatë së cilës, subjekti ka përfshirë në deklarim edhe shpenzimet e djalit të madh për akomodim dhe ushqim në konvikt.

**18.15** E njëjta situatë rezulton edhe nga deklarata e pasurisë *vetting*. Në rubrikën dedikuar të dhënave konfidenciale [në faqen 12 të deklaratës], subjekti ka deklaruar për djalin e madh 72.479 USD, ndërsa për djalin e vogël, për shkollën e mesme, në periudhën dyvjeçare, gusht 2009 – qershor 2011 – 5320 euro, e për shkollën e lartë në ShBA, në periudhën gusht 2013 – maj 2017, [përfshirë të dyja universitetet e ndjekura], vlerën 76.939 USD.

**18.16.** Nga shqyrtimi i kuadrit të zbatueshëm ligjor lidhur me detyrimin për deklarimin e shpenzimeve nga subjektet deklaruese të ligjit nr. 9049/2003, me ndryshimet përkatëse<sup>18</sup>, trupi gjykues i Kolegjit vëren se u prezantua në ligj edhe koncepti i “shpenzimeve të deklarueshme”, që tejkalonin vlerën e 500.000 lekëve. Ky koncept i referohej shumës monetare që shpenzohej për qëllime arsimit, mjekimi shëndetësor, arredimi etj. Konkretisht, referuar nenit 20 të ligjit të sipërcituar, u përcaktua se për vitin në të cilin u përcaktua ky detyrim ligjor për deklarim, shpenzimet e deklarueshme do të vlerësoheshin ato të cilat, referuar përkufizimit, do të kryheshin duke nisur nga hyrja në fuqi e ligjit e që tejkalonin vlerën 500.000 lekë. Në rastin konkret, rezulton se ligji ndryshues hyri në fuqi nga data 26 tetor 2012<sup>19</sup> e përfshiu për rrjedhojë edhe deklarimin periodik vjetor për vitin 2012. Për pasojë, duke filluar nga deklarata periodike për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte shpenzimet e jetesës e të tjera të shoqëruara me shkollimin e dy djemve në ShBA, që tejkalonin vlerën 500.000 lekë. Në vijim, ky prag shpenzimesh u ul në vlerën 300.000 lekë, nëpërmjet ligjit ndryshues nr. 45/2014.

**18.17.** Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se është i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit që fokusohet në specifikimin e ligjit dhe formularit për burimet, ndërkohë që anashkalon detyrimin për deklarimin e shpenzimeve të ndryshme që shoqëronin qëndrimin e shkollimin e djemve të tij në ShBA, të cilat, edhe nëse pranohen vlerat e referuara prej tij në hetimin administrativ, janë 6.000 USD, që nënkupton, përtej vlerës 500.000 lekë. Për pasojë, trupi gjykues vëren se subjekti ka kryer deklarime të paplota, pasi nuk ka pasqyruar shpenzimet e fëmijëve për jetesë dhe udhëtime në ShBA në deklaratat periodike për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ndonëse këto shpenzime ishin kryer dhe përmbushin qartë përkufizimin ligjor të “shpenzimit të deklarueshëm”, parashikuar në *pikën 7 të nenit 2* të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, vlerësuar në harmoni me kufirin sasior objekt deklarimi, sipas përcaktimit në *nenin 4, pika “h” e të njëjtit ligj*<sup>20</sup>. Për sa më sipër, pretendimi i Komisionerit Publik, në lidhje me mosdeklarimin e plotë të zërit të shpenzimeve të shkollimit në deklaratimet periodike pranë ILDKPKI-së për vitet e specifikuara, u gjet i drejtë dhe i bazuar.

**18.18.** Ndërsa, lidhur me deklarimin e kryer në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues e gjeti të pabazuar pretendimin e Komisionerit Publik për deklarim të pasaktë të këtyre shpenzimeve nga

<sup>18</sup> Nëpërmjet ligjit nr. 85/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

<sup>19</sup> Bazuar në datën e botimit të ligjit nr. 85/2012 në Fletoren Zyrtare.

<sup>20</sup> Këto dy dispozita parashikojnë përkatësisht: “[7.] “Shpenzim i deklarueshëm” është tërësia monetare, e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues”, si dhe: “[h] çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 300.000 (treqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit [...]”.

subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të. Në kushtet që deklarata e pasurisë *vetting* nuk kërkon në mënyrë të shprehur shpenzime shkollimi etj., subjekti rezulton të ketë deklaruar me vullnetin e tij disa vlera, duke i lidhur ato në mënyrë specifike me institucionet arsimore përkatëse, pa pretenduar apo pa lënë të kuptohet nga subjekti që në këto pagesa kanë qenë përfshirë edhe shpenzimet e jetesës, çka do të tregonte për një vullnet për t'i fshehur këto shpenzime.

**18.19.** Në përfundim të analizës së këtij shkaku ankimi, trupi gjykues arriti në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të paplotë në deklarimet periodike përpara ILDKPKI-së për shpenzimet që shoqërojnë shkollimin e jetesën e fëmijëve në ShBA. Nga ana tjetër, ky deklarim jo në përputhje me ligjin nuk cenon kriterin e vlerësimit të saktësisë së deklarimit të kryer në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë në procesin e rivlerësimit, për sa kohë këto shpenzime nuk përbënin detyrim për deklarim, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe as sipas udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””.

**19. Mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për shkollimin e dy fëmijëve të subjektit të rivlerësimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës**

**19.1** Një shkak tjetër ankimor i Komisionerit Publik lidhet me *pamjaftueshmërinë* e burimeve të ligjshme të subjektit dhe personit të lidhur kundrejt mbulimit të shpenzimeve të shkollimit të djemve të tyre në ShBA. Komisioneri Publik ka parashtruar në ankim se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm pasi nuk mbulon me të ardhura nga burime të ligjshme, depozitimet në *cash* në sistemin bankar, të përdorura për shpenzimet e shkollimit të dy djemve në ShBA për periudhën 2009 – 2014, dhe gjendet në kushtet e përcaktuara nga neni 33, pika 5, germa “b” dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik kundërshtoi konkluzionin e Komisionit në lidhje me kontrollin e këtyre shpenzime të kryera, në drejtim të periudhave të marra në analizë dhe zërave të përfshirë në analizën financiare të kryer prej tij, duke parashtruar se:

**19.2.** Analiza financiare duhet të mbante për bazë kohën e depozitimit të shumave *cash* në llogaritë bankare të subjektit dhe jo të bazohej mbi të ardhurat dhe shpenzimet e çdo viti kalendarik, sikurse ka vepruar Komisioni. Pagesat e shkollimit të dy djemve, gjatë periudhës 2009 – 2016, janë kryer kryesisht nëpërmjet transfertave nga llogaritë bankare në USD të subjektit dhe djalit të tij të vogël pranë BKT-së, shuma të cilat janë depozituar në *cash* nga subjekti i rivlerësimit<sup>21</sup>. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, se një pjesë e

---

<sup>21</sup> BKT, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 24.10.2019, ka përcjellë kopje të lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit. Nga ky dokument, rezulton se gjatë periudhës 2009 – 2014, subjekti ka depozituar në *cash*, në total 87.738 USD, shuma të cilat më pas janë transferuar për të kryer pagesat e shkollimit. ISP Bank, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 09.10.2019, ka përcjellë kopje të lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nga e cila ka rezultuar se në llogarinë dyemërore të bashkëshortes së subjektit dhe djalit të madh, në datat 23.6.2009 dhe 24.6.2009, janë depozituar në *cash* shumat 7.000 euro dhe 9.000 euro, të cilat janë tërhequr më pas

shpenzimeve për përbalimin e shkollimit të fëmijëve, kanë si burim kursimet ndër vite, nuk mbështeten në prova, për sa kohë subjekti nuk ka deklaruar ndryshim, shtim apo pakësim të kursimeve në *cash* ndër vite në deklaratat periodike vjetore.

**19.3.** Për sa i përket zërit të *kursimeve në cash*, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë kryer deklaram të pasaktë të likuiditeteve në gjendje *cash* në deklaratat periodike të viteve 2004 – 2016, pasi: (i) nuk kanë deklaruar asnjë ndryshim, shtesë apo pakësim të kursimeve *cash* në deklaratat periodike të viteve 2004 – 2014, ndërsa në harkun kohor mes procesverbalit të mbajtur në ILDKPKI më 18.03.2016 e deri më 08.04.2016, kanë deklaruar *dy vlera të ndryshme* të gjendjes së *cash*-it jashtë sistemit bankar për të njëjtën datë – 31.12.2014 – që variojnë përkatësisht nga *0 lekë* në *2.500.000 lekë*, duke pretenduar edhe 1.000.000 lekë kursime nga viti 2015, në periudhën ndërmjet këtyre dy procesverbaleve; (ii) ekzistojnë kontradikta në parashtrimet në Kolegj më 18.09.2023, mes sa ka potencuar në faqen 24 kundrejt faqes 34 të të njëjtit dokument, për gjendjen *cash* dhe ndryshimet e saj në vite.

**19.4.** Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme në vlera të ndryshme balancash negative 10 depozitat bankare, në totalin prej 63.060 USD dhe 16.000 eurosh, në disa banka të nivelit të dytë dhe tri (3) depozitimet në *cash* në totalin prej 23.178 USD, kryer në vlera të ndryshme, në harkun kohor nga 22.04.2009 deri më 19.06.2014. Përlllogaritja e parashtruar nga Komisioneri Publik, e sjellë në vëmendje të Kolegjit, bazohet në mundësitë financiare që rezultojnë nga aktet, për datën e kryerjes së transaksionit dhe faktit që subjekti nuk ka deklaruar ndryshime të kursimeve *cash*, jashtë sistemit bankar, deri në vitin 2014. Konkretisht, sipas përlllogaritjes së parashtruar në ankim, subjekti dhe personat e lidhur nuk mbulonin me burime të ligjshme depozitimet bankare të kryera si më poshtë, për një total balance negative prej minimalisht (-) 5.514.386 lekësh, pa përfshirë *cash*-in e depozituar [referuar më poshtë në këtë listë, në totalin prej 23.178 USD]<sup>22</sup>.

---

*në datat 27.7.2009 dhe 15.3.2010, dhe janë deklaruar nga subjekti të përdorura për pagesat e shkollimit të fëmijëve. Credins Bank, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.12.2019, ka përcjellë kopje të lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit, nga ku rezulton se ky i fundit ka depozituar në *cash* shumat 500.000 lekë në datën 22.4.2013 dhe 700.000 lekë në datën 1.7.2013.*

<sup>22</sup> *Veprimet financiare të parashtruara nga Komisioneri Publik në faqet 13 dhe 14 të ankimit, përfshijnë transaksionet dhe analizën për mungesën e burimeve si vijojnë: (i) shumën 15.000 USD, e depozituar nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë e tij në Bankën Kombëtare Tregtare në datën 22.4.2009, me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën (-) 772.368 lekë; (ii) shumat në total 16.000 euro, depozituar në llogarinë në Bankën Intesa SanPaolo, nga personat e lidhur [bashkëshortja dhe djali i subjektit të rivlerësimit], në datat 23 dhe 24 qershor 2009, me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën (-) 2.084.335 lekë; (iii) shumat 4.000 USD në datën 3.3.2010, 2.000 USD në datën 24.6.2010 dhe 9.550 USD në datën 2.8.2010, në llogarinë e subjektit në Bankën Kombëtare Tregtare, me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën (-) 897.553 lekë; (iv) shumën 10.610 USD, depozituar në datën 30.7.2012 në llogarinë e subjektit në BKT, me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën (-) 340.589 lekë; (v) shumat: 3.000 USD – depozituar në datën 1.7.2013, 9.000 USD – depozituar në datën 1.8.2013 dhe 1.900 USD – depozituar në datën 13.8.2013 (analizuar së bashku për shkak të afatit të shkurtër të kohës së kryerjes së tyre) në llogarinë e subjektit në Bankën Kombëtare Tregtare, me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën (-) 1.053.166 lekë; (vi) shumën 8.000 USD, depozituar në datën 19.6.2014, në llogarinë e subjektit në BKT, me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën e (-) 366.375 lekë; (vii) depozitimet në *cash* respektivisht të shumave: (a) 11.720 USD, në datën 4.1.2011, (b) 3.415 USD, në datën 4.1.2013, dhe (c) 8.043 USD në datën 3.1.2014. Shih edhe ankimin në: <https://ikp.al/wp-content/uploads/2021/02/49.Ankim->*



**19.5.** Në këto përllogaritje, Komisioneri Publik sjell në vëmendje të trupit gjykues të Kolegjit: (i) tërheqjet në *cash* nga llogaritë bankare të subjektit dhe personave të lidhur me të, për periudhat 1 janar deri në momentet e depozitimit; (ii) shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare në periudhën e analizuar; shpenzimet e qëndrimit të bashkëshortes në ShBA për periudhat 14.10.2009 – 11.6.2010, në masën 50% (25 USD/ditë) të kostos ditore të përcaktuar nga Kolegji në jurisprudencën e deritanishme, për sa kohë nga subjekti i rivlerësimit nuk është provuar mbulim i kostove të plota; (iii) depozitimet në *cash* të shumave respektive të konvertuara me kursin e publikuar nga Banka e Shqipërisë në datat e depozitimit; (iv) shpenzimet e udhëtimit për të njëjtën periudhë, si dhe çdo shpenzim tjetër të evidentuar nga analizimi i akteve në dosje.

**19.6.** Komisioneri Publik kundërshtoi përllogaritjen e kryer nga Komisioni për *shpenzimet* që shoqërojnë qëndrimin e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në periudhën 24.09.2009 – 11.6.2010, si e gabuar, e pa mbështetur në dokumentacion justifikues dhe jo në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit. Në vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nuk janë përllogaritur edhe disa shpenzime shtesë të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si *shpenzime për jetesë* në vlerat 2.000 USD – 4.000 USD, përfshirja e të cilave në analizën financiare do të ndikonte në rritjen e pamjaftueshmërisë së konstatuar prej tij.

**19.7.** Nga ana tjetër, në pretendimet përfundimtare, Komisioneri Publik pranoi si të drejta shpjegimet e subjektit gjatë gjykimit në Kolegj për dy aspekte të kontrollit të pasurisë, të cilat fillimisht ishin pjesë e ankimit, e që lidhen me të *ardhurat* e përfituara nga personi i lidhur/bashkëshortja, nga dy shoqëri tregtare [{"\*\*\*}"] ShPK dhe [{"\*\*\*}"] ShPK], sikurse edhe depozitën e vlerës 15.000 euro në një llogari dyemërore të padekluar të bashkëshortes dhe së motrës së saj në vitin 2010. Konkretisht, ndërsa në ankim Komisioneri Publik argumentoi se të ardhurat e bashkëshortes nga këta dy persona juridikë nuk përmbushnin kriterin e ligjshmërisë sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për shkak se për to nuk provohej pagesa e detyrimeve tatimore, në parashtrimet përfundimtare, në datën 26.09.2023, ai kërkoi që të përfshiheshin në mesin e fondeve në dispozicion të familjes për vitet përkatëse, nisur nga sa konfirmojnë dy akte të sjella nga subjekti gjatë procesit të zhvilluar në Kolegj dhe konfirmimit nga bankat. Po në të njëjtën linjë, Komisioneri Publik parashtrroi se shpjegimet dhe aktet e sjella nga subjekti për burimin e krijimit të shumës prej 15.000 eurosh, depozituar në bankë, ishin të drejta.

**19.8.** Në parashtrimet para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi pretendimet e Komisionerit Publik për këtë shkak ankimi, duke i vlerësuar të pabazuara në ligj dhe në rrethanat e faktit të provuara nga hetimi administrativ i Komisionit. Qasja e Komisionerit Publik për vlerësimin e analizës financiare, bazuar në momentin e depozitimit të shumave në *cash* në

---

*kund%3%ABr-vendimit-nr.-318-dat%3%AB-3.12.2020-t%3%AB-KPK-s%3%AB-p%3%ABr-sr-z.-Kujtim-Luli.pdf.*

llogaritë bankare, është e paqartë, e pabazuar në referenca ligjore, metodikë financiare apo manuale të miratuara sipas ligjit, apo si orientim i jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Si e tillë, ajo është e njëanshme dhe joproporcionale, ka deformuar logjikën e vazhdimësisë ligjore financiare. Analiza financiare duhet të analizohet e vazhdueshme, nën dritën e gjendjes së mbartur të *cash*-it të krijuar me burime të ligjshme dhe i deklaruar në vitin 2003 sipas ligjit.

**19.9.** Lidhur me zërat e analizës financiare të kryer nga Komisioni, të cilat janë pjesë e ankimit të Komisionerit Publik, subjekti parashtroi në mënyrë të përmbledhur sa më poshtë.

(i) Të ardhurat e bashkëshortes nga dy personat juridikë tregtarë [{"\*\*\*"} ShPK dhe [{"\*\*\*"} ShPK] provohen me deklaratën e pasurisë *vetting*, të shoqëruar me vërtetimet/aktet përkatëse bashkëlidhur, me deklaratimet në DPV-2009 në ILDKPKI, me aktet/dokumentet përkatëse (kontrata shërbimi/pune me kohë të pjesshme dhe vërtetime të DRT-së), si dhe shpjegimet në hetimin administrativ në Komision, në ligjin e zbatueshëm dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit. Shoqëritë e sipërcituara tregtare kanë marrë përsipër të paguajnë tatimin në burim mbi të ardhurat e përcaktuara në kontratat për shërbimet avokatore të kryera nga bashkëshortja, në bazë të kontratave dhe të ligjit nr. 8438/1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Vënia në dyshim e përfitimit të pagesës vjetore takuese sipas kontratës së lidhur me shoqërinë tjetër [{"\*\*\*"} ShPK], brenda muajit prill 2009, rëndon në mënyrë të padrejtë pozitën e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Bëhet fjalë për një kontratë shërbimi ku marrëdhënia shërbim/pagesë rregullohet mes palëve. Shoqëria [{"\*\*\*"} ShPK i ka paguar bashkëshortes së tij të gjithë pagesën vjetore takuese për vitin 2009 sipas kontratës, në muajin mars 2009, pas përfundimit të çështjes gjyqësore me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.02.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Këtë vendim, subjekti i rivlerësimit e depozitoi së bashku me parashtresat e tij në Kolegj, në cilësinë e provës në këtë proces.

(ii) Është i pabazuar pretendimi i Komisionerit Publik se kreditimet në llogarinë e personit të lidhur pranë Tirana Bank nuk janë deklaruar në deklaratat periodike të viteve 2008 dhe 2009 dhe atë të pasurisë *vetting*, e as nuk janë hetuar nga Komisioni nëse përmbushin përcaktimet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Këto kreditime janë kryer në funksion të aktivitetit privat të ushtruar nga bashkëshortja/personi i lidhur, për të cilin të ardhurat e krijuara ishin deklaruar rregullisht. Pagesat e përftuara në janar dhe shkurt 2009, u takonin shërbimeve të ofruara gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2008, fakt që provohet edhe nga përshkrimi i kreditimit të kryer nga shoqëria [{"\*\*\*"} ShPK]. Këto të ardhura ishin deklaruar të krijuara nga aktiviteti privat i bashkëshortes si avokate dhe ato nuk ishin objekt tatimi në burim.

(iii) Kursimet në *cash* duhet të konsiderohen ndër vite si burim për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të shkollimit të dy fëmijëve. Pasaktësitë e pretenduara në ankim për deklaratimet e likuiditetit jashtë sistemit bankar [*cash*] ndër vite nuk shoqërohen me mungesa të burimeve të ligjshme për krijimin e tyre. Së bashku me të ardhurat familjare për çdo vit, *cash*-i ka shërbyer për të përballuar shpenzimet për shkollimin e djemve e, për pasojë, nuk mund të kualifikohen si ndonjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

(iv) Ekzistenca e kursimeve në *cash* në shumën 3.000.000 lekë, për periudhën 1991 deri në fillim të vitit 2003, sikurse edhe shuma 2.000.000 lekë e krijuar gjatë vitit 2003 [në total 5.000.000 lekë *cash* përpara deklarimit të parë, sipas ligjit nr. 9049/2003], është verifikuar gjatë kontrollit në ILDKPKI në mars të vitit 2016, kur ka dhënë shpjegimet e tij, ndër të tjera edhe për burimin e krijimit të gjendjes *cash* të vlerës së deklaruar në deklaratën e vitit 2003. Këto likuiditete kanë shërbyer për të balancuar të ardhurat me shpenzimet e shkollimit të fëmijëve çdo vit, sipas faturave përkatëse, në fillimin e vitit të ri financiar, si dhe gjatë vitit, në momentet kur janë kryer transfertat për shpenzimet e shkollimit të djemve.

(v) Ndryshe nga sa pretendon Komisioneri Publik, ai dhe bashkëshortja kanë bërë të njëjtin deklaram në deklaratën fillestare të vitit 2003, duke deklaruar dy fletë të formularit A-5, ku përfshihen reciprokisht të dyja shumat (3.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë). Për rrjedhojë, pretendimi i Komisionerit Publik për mungesën e *cash*-it në vlerën e 2.000.000 lekëve vetëm se nuk gjendet formulari i bashkëshortes A-5, është i pabazuar në prova dhe nuk është ngritur as gjatë hetimit në ILDKPKI dhe as gjatë hetimit në Komision. Komisioni ka hetuar nëse subjekti kishte mundësi të krijonte shumën prej 3.000.000 lekësh deri në fund të vitit 2002, duke konkluduar në favor të subjektit të rivlerësimit.

(vi) Mosdeklarimi i ndryshimeve, shtesave apo pakësimeve të gjendjes *cash* në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 – 2014, ka qenë pasojë paqartësie në plotësimin e rubrikës në deklaratimet periodike vjetore për këtë aspekt. Këtë sqarim, ai e ka bërë për ILDKPKI-në në “Shpjegimet shtesë”, datë 28.03.2016, administruar si provë në Komision, dhe më tej e ka reflektuar në deklarinimin në DPV-në e vitit 2015, ku ka deklaruar kursimet e tij në *cash* dhe kursimet e djalit të madh në ShBA deri më 31.12.2015, sikurse edhe në vijim.

(vii) Në konkluzionet përfundimtare para Kolegjit, subjekti u shpreh se gjendja e *cash*-it 1.000.000 lekë në deklarinimin në ILDKPKI për vitin 2015, *pjesërisht ka qenë e mbartur*, ndërsa pjesa tjetër është krijuar nga të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes, si dhe “nga kursimet gjatë vitit 2015”. Në deklaratën *vetting*, në janar 2017, kursimet kanë qenë në bankë të deklaruara dhe nuk ka pasur *cash* jashtë sistemit bankar.

(viii) Depozitimet në bankë në vitet 2009 – 2014 nuk mund të kenë burim vetëm pagat e tre apo katër muajve, pasi kjo mënyrë të vepruari është në shkëlqje të neni 4, pika 1 e ligjit nr. 9049/2003, që normon afatet dhe objektin e deklarimit dhe nenit 25, pikat 1 dhe 2 të njëjtit ligj, që normojnë llojet e kontrolleve sipas metodikave apo manualeve të parashikuara në ligj, ashtu dhe qëndrimeve të konsoliduara të Kolegjit. Burimi i të gjitha depozitimeve të listuara nga Komisioneri Publik janë nga gjendja *cash*, në vlerë 5.000.000 lekë, e deklaruar në vitin 2003, dhe e pandryshuar deri në vitin 2009, e përdorur në periudhën e viteve 2009-2014 për shpenzimet për shkollimin e fëmijëve. Pagesat e kryera kompensoheshin në muajt në vazhdim të viteve përkatëse me të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes, dhe pas vitit 2013, edhe nga paga e djalit të madh. Në mbështetje të sa më sipër, së bashku me konkluzionet përfundimtare, subjekti depozitoi edhe

pesë pasqyra të fluksit të mjeteve monetare (*cash flow*), nga të cilat provohej mjaftueshmëria e mjeteve monetare për të përballuar shpenzimet e shkollimit të dy djemve të tij.

ix) Subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi pretendimin e Komisionerit Publik për llogaritje të gabuar të kryer nga Komisioni për shpenzimet e qëndrimit të personit të lidhur/bashkëshortes në ShBA në periudhën shtator 2009 – qershor 2010, dhe vlerësimin e tyre në masën e 50% (25 USD dita) të kostos ditore të përcaktuar nga Kolegji në jurisprudencën e deritanishme. Gjatë kësaj periudhe, bashkëshortja e tij ka qëndruar në kampus me djalin dhe kostot e jetesës nuk mund të llogariten si ato të një personi i cili gëzon statusin e të dërguarit me një punë të caktuar dhe që përfiton të ardhura të veçanta për të përballuar me dinjitet qëndrimin. Jeta në kampus karakterizohet si ajo e çdo studenti, i cili ka kostot më minimale të jetesës dhe kosto qëndrimi sipas census-it të ShBA-së. Për llogaritja e kostove të qëndrimit me 5 USD dita është e drejtë dhe e bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>23</sup>.

x) Llogaria dyemërore e çelur në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe motrës së saj, ku ishin depozituar 15.000 euro në *cash*, në datën 18.08.2010, i përket dhe përdoret vetëm nga motra dhe mbesa e bashkëshortes së tij. Së bashku me parashtrimet, subjekti depozitoi në cilësinë e provës një lëvizje të llogarisë bankare në fjalë, çelur nga mbesa e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për periudhën 2007 e në vazhdim. Prej këtyre akteve, ai referoi se shuma prej 15.000 eurosh e kishte origjinën nga tërheqja e kryer më datë 13.08.2010 nga llogaria rrjedhëse e pagës së mbesës.

**19.10.** Trupi gjykues i Kolegjit kreu analizën e shkaqeve të ankimit dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, sipas akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim. Në vijim të kësaj analize, për shkaqet e ankimit të cilat gjetën pasqyrim edhe në parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e Komisionerit Publik janë të bazuara. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur një mungesë burimesh në vlerën (-) 4.527.325 lekësh, për t'i përballuar këto depozitime në kohën kur janë kryer. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për paqartësi në plotësimin e deklaratave periodike vjetore, pavarësisht nga shkaqet e parashtruara prej tij, janë jobindëse dhe bien ndesh me gjuhën e qartë të ligjit nr. 9049/2003. Së fundmi, pretendime të kësaj natyre, sikurse ka konstatuar Kolegji në vendime të mëparshme, bien ndesh edhe me profilin dhe përvojën e konsiderueshme profesionale të subjektit si magjistrat prokuror që ka shërbyer në pozicione që kërkojnë përgjegjësi, qartësi dhe njohuri të sofistikuar në interpretimin e ligjit, në funksion të të drejtave të individëve dhe interesit publik në ndjekjen penale<sup>24</sup>.

**19.11.** Në këtë analizë, sikurse parashtrroi edhe Komisioneri Publik dhe në vijim të frymës së nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, sikurse zbërthyer edhe në vazhdimësi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendime të mëparshme, analiza financiare e

<sup>23</sup> Subjekti i referohet këtu vendimit të Kolegjit nr. 11, datë 22.05.2019.

<sup>24</sup> Shih, ndër të tjerë, edhe vendimin e Kolegjit në çështjen JR nr. 27/2020 që i përket subjektit të rivlerësimit D. Peka, paragrafin 19.4.v apo paragrafin 27.12.16 në vendimin në çështjen JR nr. 11/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit E. Islami.

mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme u vlerësua duke mbajtur në konsideratë momentin e kryerjes së transaksioneve, që në rastin konkret është momenti i depozitimit të shumave *cash* në llogaritë bankare të subjektit dhe personave të lidhur me të. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe faktin që likuiditetet në rastin objekt gjykimi, si vlera monetare të krijuara kryesisht në formën e depozitave afatshkurtra në bankë, në zbatim të parashikimit të nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/2003, janë objekt deklarimi për sa i përket vlerës së tyre, sikurse edhe burimit të krijimit.

**19.12.** Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues vëren se detyrimet ligjore të përcaktuara për subjektet deklaruese përcaktojnë njëkohësisht edhe objektin e veprimtarisë së organeve që do të kryejnë verifikimin e ligjshmërisë dhe mjaftueshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive/interesave privatë objekt deklarimi, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003 [me ndryshimet përkatëse], e në rastin konkret, të likuiditeteve në formën e depozitave bankare. Ky vlerësim i trupit gjykues vjen në harmoni edhe me udhëzimin e Inspektorit të Përgjithshëm nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, i cili udhëzon subjektet e rivlerësimit për mënyrën e deklarimit të pasurive, si dhe të mbledhjes së dokumentacionit justifikues që do t’i nënshtrohet shqyrtimit dhe vlerësimit të institucioneve të ngarkuara me procesin e rivlerësimit kalimtar, i cili i referohet dokumentacionit ligjor që justifikon ligjshmërinë e burimit të krijimit të secilës pasuri (përfshirë likuiditetet në bankë), në momentin e krijimit të tyre<sup>25</sup>.

**19.13.** Në konsideratë të sa më sipër dhe të faktit që shumat *cash* janë depozituar në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur në funksion të pagesës së tarifave të shkollimit të dy djemve, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se Komisioni duhet të kishte kryer kontrollin e ligjshmërisë së tyre [depozitimeve]. Në kushtet që për shkak të kësaj dinamike, këto shuma fondesh nuk përbënin gjendje financiare për t’u deklaruar në deklaratën periodike vjetore si gjendje në datën 31 dhjetor të viteve përkatëse, e rrjedhimisht, nuk linin gjurmë për burimet financiare të përdorura, kontrolli nga Komisioni duhet të ishte kryer nëpërmjet analizës së ligjshmërisë dhe mjaftueshmërisë së burimeve financiare të disponueshme nga subjekti i rivlerësimit në *momentin e kryerjes* së depozitimeve, dhe jo nëpërmjet përfshirjes në analizë të burimeve financiare të krijuara *pas datës së depozitimeve*, sikurse ka vepruar Komisioni duke përfshirë të ardhurat e gjithë vitit.

---

<sup>25</sup> Pika 7 e udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 “Për [...]”, përcakton: “Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre”.

**19.14.** Në kuadër të kontrollit të analizës financiare të Komisionit lidhur me mbulimin e shpenzimeve të shkollimit të djemve të subjektit të rivlerësimit, në dritën e konkluzionit të arritur më sipër, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimet e Komisionerit Publik për zërat konkretë të saj [analizës], si dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultojnë me mungesë burimesh në vlerën (-) 4.527.325 lekësh. Arsyetimi dhe analiza ligjore mbi të cilën bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

*i. Në lidhje me zërin e të ardhurave*

**19.15.** Sikurse referuar edhe më sipër, në kushtet që në fazën procedurale të konkluzioneve përfundimtare, Komisioneri Publik vlerësoi se subjekti i rivlerësimit provoi me aktet e sjella se të ardhurat e personit të lidhur/bashkëshortes nga ky person juridik, përmbushin kriterin e ligjshmërisë përcaktuar nga kuadri kushtetues e ligjor që gjen zbatim<sup>26</sup>, trupi gjykues i Kolegjit çmoi të panevojshëm arsyetimin e mëtejshëm në drejtim të shkaqeve të ngritura në ankimin e Komisionerit Publik dhe përfshiu këto të ardhura në analizë, në vlerën e përlllogaritur nga Komisioni. Në të njëjtën linjë, trupi gjykues vlerësoi edhe argumentet e Komisionerit Publik në parashtrimet përfundimtare për sa i përket një depozite dyemërore të bashkëshortes së subjektit me motrën e saj, duke pranuar qëndrimin e Komisionit për këtë aspekt<sup>27</sup>.

*ii. Në lidhje me zërin e shpenzimeve*

**19.16.** Trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik për mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të qëndrimit të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në ShBA për periudhën kohore 24.9.2009 – 11.06.2010, mbi bazën e metodologjisë së përcaktuar nga Kolegji<sup>28</sup> për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta. Vlera 5 USD/ditë, përlllogaritur nga Komisioni, u korrespondon situatave në të cilat është provuar që shpenzimet e qëndrimit jashtë vendit janë mbuluar nga personat e tretë pritës, ndërsa kjo vlerë përbën një vlerë simbolike për shpenzime bazike, e që nuk mund të gjejë zbatim në një qëndrim afatgjatë me shpenzime të përballuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për shkollimin e jetesën e djalit në ShBA, sikurse është situata faktike konkrete. Në kushtet kur qëndrimi dhe jetesa e djalit është financuar tërësisht me të ardhurat e prindërve, mbulimi i shpenzimeve të jetesës me të njëjtat të ardhura për dy persona, për disa muaj, natyrshëm shoqërohet me kosto përtej asaj të përlllogaritur vetëm për një student. Duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se koha e qëndrimit në ShBA ka qenë relativisht e gjatë – përreth 8 muaj – trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se shpenzimet e qëndrimit të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit duhet të përlllogariten duke iu referuar shpenzimeve të jetesës sipas census-it<sup>29</sup> në ShBA, referuar edhe shpjegimit të subjektit të rivlerësimit në parashtrimet e tij para

<sup>26</sup> Paragrafi 2.3.1, faqja 4 e parashtrimeve përfundimtare të Komisionerit Publik.

<sup>27</sup> Si më sipër, paragrafi 2.6, faqja 6 e parashtrimeve përfundimtare.

<sup>28</sup> Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 11/2019, parag. 27.7.

<sup>29</sup> Shih: [Poverty Thresholds \(census.gov\)](http://Poverty Thresholds (census.gov)), tabela që i përket vitit 2009 dhe vitit 2010, për një familje me 2 persona. Shpenzimet e qëndrimit janë përlllogaritur vetëm për 1 person (bashkëshorten e subjektit).

Kolegjit, nga ku rezultoi se për periudhën 24.09.2009 – 31.12.2009, kostoja ditore e qëndrimit ishte 19,78 USD/ditë, ndërsa për periudhën 1.1.2010 – 11.6.2010, kostoja ditore e qëndrimit ishte 20,10 USD/ditë.

*iii. Në lidhje me likuiditetet jashtë sistemit bankar [kursimet në cash]*

**19.17.** Trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të bazuar në ligj pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë kryer deklaram të pasaktë të likuiditeteve në gjendje *cash* në deklaratat periodike të viteve 2004-2016 dhe sikurse referuar edhe më sipër, konstatoi se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të përballuar shkollimin e dy fëmijëve për vitet 2009 – 2014. Trupi gjykues i Kolegjit i gjeti jobindëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit se depozitimet ndër vite të *cash*-it kanë pasur si burim kursimet në likuiditete jashtë sistemit bankar, në vlerën 5.000.000 lekë, e deklaruar në vitin 2003, e të cilat kanë qëndruar të pandryshuara deri në vitin 2014, në saje të zëvendësimit të tyre deri në fund të vitit përkatës me të ardhura familjare. Ky konkluzion mban në konsideratë jo vetëm mospërputhjet e kontradiktat në pohimet e subjektit të rivlerësimit në momente të ndryshme në kohë për sasinë e akumuluar në momente të caktuara, por edhe në analizë të sa rezulton nga deklaratat periodike vjetore apo nga rrethanat e thjeshta të faktit, të cilat, të para së bashku ndër vite, tregojnë mungesë transparence e sinqeriteti nga subjekti i rivlerësimit. Ndërkohë që nevojat financiare të familjes rriten në mënyrë eksponenciale në saje të shpenzimeve që shoqërojnë shkollimin e dy fëmijëve në një vend si ShBA, subjekti argumenton se likuiditetet nga viti 2003, mbeteshin të paprekura në atë masë sa që e bëjnë, sipas tij, të pazbatueshëm kërkimin e ligjit nr. 9049/2003 për të reflektuar pakësime e ndryshime në likuiditetet jashtë sistemit bankar. Ky konkluzion mbështetet në arsyetimin në vijim.

**19.18.** Së pari, sikurse ka konstatuar edhe Komisioneri Publik, subjekti nuk ka deklaruar *cash* jashtë sistemit bankar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit [deklarata *vetting*]. Së dyti, sikurse ka potencuar edhe Komisioneri Publik, subjekti dhe bashkëshortja kanë dorëzuar dy formularë A-5 secili në deklaramin e parë, në mars 2004 [me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9049/2003], në të cilët subjekti ka dhënë dy vlera të ndryshme likuiditetesh, përkatësisht *3 milionë lekë* e *2 milionë lekë*, me të njëjtat burime dhe pa asnjë specifikim dallues mes dy formularëve, ndërsa bashkëshortja ka dhënë të njëjtën vlerë, *3 milionë lekë cash*, me burimin e referuar njësoj si subjekti i rivlerësimit – të ardhura nga paga dhe honorarët e deklaruar. Subjekti e ka dorëzuar këtë deklaratë të parë të tij më 20.03.2004, ndërsa bashkëshortja – edhe ajo subjekt deklarues në atë kohë – një ditë më pas, më 21.03.2004. Më 18.03.2016, gjatë kontrollit të ushtruar nga ILDKPKI, për sa u përket burimeve të krijimit të kursimeve “në vlerën 3.000.000 lekë” të deklaruar në deklaratën e parë, sipas pyetjes së inspektorit, subjekti ka referuar të ardhurat nga puna e tij dhe specifikuar punësimet si prokuror e pedagog. Qartazi, referenca ka qenë për vlerën 3.000.000 lekë. Për herë të parë, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka dhënë shpjegime duke u shprehur se në fakt flitet për 5.000.000 lekë, nga të cilat, shuma 2.000.000 lekë ishin të ardhurat e vitit 2003, ndërsa të tjerat, të ardhurat deri në vitin 2003.

**19.19.** Komisioni ka kryer analizë financiare për të dyja vlerat dhe subjekti e personi i lidhur kanë dalë me të ardhura me burime të ligjshme të mjaftueshme qoftë për vlerën 3.000.000 lekë,

qoftë për vlerën 5.000.000 lekë. Komisioneri Publik potencon se vetëm vlera 3.000.000 lekë është e besueshme, pasi ajo rezulton e konfirmuar në analizën kryqëzuese me deklaratën e dorëzuar nga personi i lidhur/bashkëshortja, për të njëjtën situatë e në të njëjtin moment në kohë. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik, dhe jobindëse shtesën e vlerën 2.000.000 lekë, duke mbajtur në konsideratë edhe konstatimin e shpjegimet e vetë subjektit në vitin 2016 në ILDKPKI, sikurse edhe faktin që specifikimet që pretendon subjekti për vlerën shtesë si pasqyrim i kursimeve të vitit 2003, nuk kanë gjetur pasqyrim në deklaratë në asnjë formë. Përkundrazi, në shpjegimet e dhëna para ILDKPKI-së, referuar procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim në datën 18 mars 2016, për pyetjen e inspektore për gjendjen e *cash*-it në vlerën 3.000.000 lekë, për të cilën është pyetur të sqarohet burimin e krijimit, subjekti i rivlerësimit ka referuar pagat nga punësime të ndryshme të tij, përfshirë edhe: “[...] si pedagog i jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë në vitet 2000-2003 dhe në Shkollën e Magjistraturës në vitet 2000-2003”, sikurse edhe ato të bashkëshortes si gjyqtare, inspektore e Ministrisë së Drejtësisë e [...] deri në vitin 2005 te Shkolla e Magjistraturës”. Qartazi, subjekti ka folur për vlerën 3.000.000 lekë dhe ka përfshirë edhe të ardhurat e vitit 2003 në mundësinë e krijimit të kësaj vlere.

**19.20.** Me fjalë të tjera, subjekti është pyetur për likuiditetin *cash* në vlerën e 3.000.000 lekëve dhe jo të 5.000.000 lekëve në deklaratën për herë të parë dhe nuk rezulton ta ketë kundërshtuar këtë fakt, e ka përfshirë në harkun kohor gjatë të cilit janë gjeneruar këto të ardhura edhe vitin 2003. Mbi bazën e kësaj situatë faktike, është kryer edhe kontrolli nga ILDKPKI-ja, e cila në raportin në kuadër të rivlerësimit të subjektit ka konstatuar: “[...] Në deklaratën “Para fillimit të detyrës 2003”, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 3.000.000 lekë dhe nuk ka deklaruar ndryshime të saj në deklaratat e interesave privatë ndër vite. Në *vetting* nuk ka deklaruar gjendje *cash* [...]”. Ky fakt krijon bindjen se këto kanë qenë vlerat dhe harku kohor takues në atë datë, pavarësisht se në “Shpjegimet shtesë”, të dhëna po në ILDKPKI, disa ditë më vonë, në datën 28.03.2016, subjekti ka paraqitur një situatë të re, të ndryshme e duke referuar një paraqitje në formë tabelare të të ardhurave/shpenzimeve dhe kursimeve për periudhën 1991 – 2014, në linjë me sa pretenduar në Kolegj, se kursimi deri në vitin 2003 ka qenë 3.000.000 lekë, ndërsa kursimi i vetë vitit 2003 ka qenë 2.606.400 lekë (në total një kursim prej 5.606.400 lekësh).

**19.21.** Për sa më sipër, pretendimet e subjektit përpara Kolegjit se deklarimi i tij dhe ai i bashkëshortes nuk kanë ndryshime mes tyre, apo që nëpërmjet dy formularëve ka pasur synim të deklaronte veçmas kursimet që i përkisnin vetëm vitit 2003 në vlerën 2.000.000 lekë, janë të pakuptimta pasi qartazi nuk pasqyrojnë realitetin qoftë referuar shpjegimeve të tij në mars 2016, qoftë edhe deklarimin e personit të lidhur/bashkëshortes që është identik në të dy formularët A-5. Ndryshe nga qëndrimi i mbajtur në Kolegj, i cili vjen në mbështetje të qëndrimit përfundimtar të Komisionit, kur është pyetur nga ky i fundit gjatë procedurës së hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar që vlera e këtij likuiditeti ka qenë 5.000.000 lekë. Përkundrazi, referuar shpjegimeve të dhëna në lidhje me burimin e krijimit të likuiditetit gjendje *cash*, subjekti është shprehur se ky likuiditet është i mbartur dhe i krijuar nga burime të ndryshme të ardhurash të krijuara prej tij dhe bashkëshortes, duke përfshirë edhe ato të vitit 2003. Deklarimi i dytë i subjektit të rivlerësimit (vlera 2 milionë lekë), sikundër është shprehur dhe ai vetë në përgjigjen e pyetësorit nr. 3 të Komisionit, ka ardhur në vijim të sqarimit nga ana e përfaqësuesit të



inspektoratit të ulët në Prokurorinë e Përgjithshme, se në kuptim të parashikimit të ish-nenit 6 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, në deklaratën për herë të parë subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte gjendjen e akumuluar të likuiditeteve, përfshirë dhe *cash*-in, deri në momentin e deklarimit. Logjikisht, ky fakt nënkupton që nëse gjendja e akumuluar e kursimit *cash* do të ishte 5.000.000 lekë, të njëjtën vlerë duhet të dëshmonte dhe Formulari A-5, i plotësuar herë të dytë.

**19.22.** Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues vlerësoi se qëndrimi i Komisionit për vlerësimin e deklarimit të kryer lidhur me likuiditetin gjendje *cash* në banesë në deklaratën për herë të parë, sipas të cilit ka pranuar si vlerë të këtij likuiditeti shumën prej 5.000.000 lekësh, është vlerësim i pabazuar në fakte dhe në ligj. Pavarësisht dhe cilado të jetë vlera e konsideruar e akumuluar deri më 31 dhjetor 2003, qëndron konstatimi i Komisionerit Publik se kjo gjendje *cash*-i nuk ka gjetur asnjë pasqyrim për shtesa, pakësime apo ndryshime deri në vitin 2014. Trupi gjykues i Kolegjit i gjen jobindëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit, i cili ka pretenduar mbulimin e disa prej shpenzimeve të kryera ndër vite në saje të tyre, por nuk rezulton të ketë deklaruar pakësime të këtij likuiditeti në deklaratimet periodike ndër vite. Sikundër pretendoi edhe Komisioneri Publik, në analizën financiare të kryer në Komision, këto kursime nuk janë përfshirë si burim për mbulimin e shpenzimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të, duke qenë se shpenzimet e shkollimit janë analizuar në kuadër të analizës vjetore të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe jo në momentin e depozitimeve të shumave *cash* në bankë.

**19.23.** Në vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve të kryera nga subjekti për shkollimin e fëmijëve, trupi gjykues i Kolegjit analizoi edhe deklaratat periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit – të cilat përbëjnë provë në këtë proces – për të krijuar një panoramë të plotë të të ardhurave dhe kursimeve, referuar detyrimit të subjektit ndër vite, nën dritën e ligjit nr. 9049/2003 për të deklaruar interesat e tij privatë. Sikurse referuar gjerësisht edhe më sipër, nga aktet në fashikull rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, referuar deklaratave periodike të viteve 2004 – 2016, kanë deklaruar kursimin në formë *cash*-i në deklaratën për herë të parë në vitin 2004 – deklarim që karakterizohet nga problematikat e adresuara më sipër – dhe asnjë shtesë apo pakësim të këtij likuiditeti deri në deklarimin e kryer në datën 20.03.2016, që i korrespondon deklaratës periodike për vitin 2015. Në këtë moment kohor, në mënyrë kontradiktore, subjekti i rivlerësimit ka dhënë tri variante të ndryshme të gjendjes së *cash*-it jashtë sistemit bankar, në harkun kohor nga 18.03.2016 deri më 28.03.2016.

**19.24.** Konkretisht, pasi i ishte nënshtruar kontrollit periodik nga ILDKPKI-ja, më 18.03.2016, e kishte deklaruar gjendje *cash*-i në vlerën 0 lekë deri më 31.12.2014, më 20.03.2016 – në deklaratën periodike për vitin 2015 – ka deklaruar 1.000.000 lekë nga të ardhurat e vitit 2015 nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, gjendje më 31 dhjetor 2015. Në shkresën e pranuar në ILDKPKI-ja më 08.04.2016<sup>30</sup>, titulluar “Shpjegime shtesë”, subjekti sjell një situatë financiare të ndryshme të *cash*-it, duke u shprehur: “[...] kursimet e mia *cash* deri më 31.12.2014, kanë qenë në vlerë

<sup>30</sup> Shpjegimet shtesë të subjektit mbajnë datën 28.03.2015, ndërsa vula e pranimi në ILDKPKI mban datën 08.04.2016. Në kushtet që subjekti referon ndërveprime me ILDKPKI-në më 25 mars të të njëjtit vit, viti 2015 i vendosur prej tij në krye të dokumentit, është qartazi gabim shtypi.

2.500.000 lekë. Këto kursime, plus të ardhurat e deklaruara për vitin 2015, në vlerë 2.486.000 lekë, janë përdorur për të mbuluar shpenzimet e deklaruara për vitin 2015. Gjendja *cash* e mbetur dhe e deklaruar deri më 31.12.2015, është në vlerë 1.000.000 lekë [...]”.

**19.25.** Me fjalë të tjera, pavarësisht titullit të zgjedhur prej subjektit, kjo shkresë e tij nuk përbën shtesë, por në thelb zhbën në tërësi deklarinin e tij përpara pak javësh [datë 18.03.2016] në ILDKPKI. Trupi gjykues vëren se ky ndryshim logjikisht bëhet si reflektim i deklarinimit periodik vjetor të vitit 2015, dorëzuar në harkun kohor mes procesverbalit të parë në ILDKPKI dhe “Shtesës” në fjalë. Ky deklarinim i kryer prej subjektit, bie ndesh edhe me faktin që deri në atë moment kohor, subjekti nuk ka deklaruar ndryshime të *cash*-it që nga marsi i vitit 2004.

**19.26.** Lexuar nën dritën e udhëzimeve të shprehura në ligjin nr. 9049/2003, për të deklaruar vetëm “*ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë, të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji, ata të lindur gjatë vitit që deklarohet dhe çdo e ardhur e fituar dhe shpenzim i deklarueshëm, i kryer gjatë gjithë vitit për të cilin bëhet deklarinimi*”<sup>31</sup>, deklarimet e subjektit për *cash*-in e disponuar në vitet 2014 e 2015, edhe duke abstraguuar nga fakti që janë tejet kontradiktore, nënkupton disa situata, në varësi të cilit prej “shpjegimeve/deklarimeve” të tij merret për bazë. Konkretisht, nëse pranohet shpjegimi i tij më 18.03.2016 [në ILDKPKI], për “0 lekë në fund të vitit 2014”, sipas logjikës së ligjit deduktohet që subjekti ka shpenzuar gjithë fondet në një moment të papërcaktuar përpara dhjetorit 2014, por nuk ka kryer deklarimet përkatëse sipas ligjit, shtesat e pakësimit. E njëjta situatë deduktohet edhe nëse analiza kryhet mbi bazën e deklaratës periodike për vitin 2015, dorëzuar dy ditë pas pohimit të sipërcituar të subjektit në ILDKPKI [më 20.03.2016], por edhe që gjatë vitit 2015, ai dhe personi i lidhur kanë krijuar një *gjendje* 1.000.000 lekë. Nga ana tjetër, nëse merret në konsideratë versioni i paraqitur prej tij një-dy javë më pas, si “Shpjegimet shtesë” pranuar në ILDKPKI në prill 2016, situata e prezantuar ndryshon katërçipërisht. Sipas këtij versioni të ri, subjekti rezulton të ketë shpenzuar vetëm 500.000 lekë nga kursimet e deklaruara në mars 2004 gjatë vitit 2014 – ose ndër vite, pa deklaruar sipas ligjit – dhe gjendja më 31.12.2014 ishte 2.500.000 lekë. Kjo situatë do të nënkuptonte – gjithmonë lexuar sipas kërkesave të shprehura të ligjit nr. 9049/2003 – që kursimet e deklaruara në deklaratën e parë nuk janë përdorur ndër vite, deri në vitin 2014, dhe në këtë periudhë të fundit, vetëm 500.000 lekë prej tyre. Nga ana tjetër, referuar aktit të ekspertimit ekonomik-financiar, datë 10.12.2022, të depozituar nga subjekti në cilësinë e provës, së bashku me parashtrimet e tij në Kolegj, si dhe pasqyrave të fluksit të mjeteve monetare (*cash flow*) [Aneksi 1 deri në Aneksin 5], të depozituara bashkëlidhur konkluzioneve përfundimtare, kursimet në fund të vitit 2014 pretendohet të jenë në vlerën e 1.500.000 lekëve.

**19.27.** Nën dritën e kontradiktave të mësipërme në shpjegimet e tij, subjekti parashtroi një version në Kolegj, sipas të cilit të ardhurat në fund të çdo viti, për 11 vjet, kanë qëndruar të pandryshuara në shifër – ekzaktësisht siç ato ishin në fund dhjetorin e vitit 2004, në vlerën 5.000.000 lekë – sipas pretendimeve të tij e, për pasojë, nuk kishte detyrim të deklaronte shtesa e pakësime. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim paraqitet jobindës për disa arsye. Së

<sup>31</sup> Shih nenin 7 të ligjit nr. 9049/2003, me ndryshimet përkatëse dhe formularin e deklarinimit periodik vjetor, faqe 3.

pari, në logjikën e thjeshtë, duket një koincidençë joprobabile që vlera ndër vite të mos pësojë asnjë pakësim apo shtesë, qoftë edhe nominale, ndërkohë që flitet për një hark kohor mbi 10-vjeçar e nevojat familjare rriten. Së dyti, ky version rezulton jobindës edhe duke pasur parasysh që ndërsa për të paktën 10 vjet, këto fonde mbeteshin të pandryshuara në vlerën ekzakte fillestare, referuar edhe pretendimeve të subjektit në Kolegj<sup>32</sup>, në vitin 2016, për herë të parë pasi subjekti iu nënshtrua kontrollit periodik të ILDKPKI-së, ato pësojnë ndryshime drastike: nga 0 lekë, në 2.500.000 lekë në vitin 2015, apo 1.500.000 lekë sipas akteve të paraqitura në Kolegj.

**19.28.** Nga aktet në fashikull, nuk rezulton asnjë situatë e re financiare që do ta ndikonte në shpenzimet e shtuara në mënyrë determinante, për të bërë bindëse uljen e shpenzimeve të konsiderueshme sipas deklaramit të parë në kontrollin e ushtruar nga ILDKPKI-ja më 18.03.2016, qoftë atë të deklaruar në “Shpjegimet shtesë”. Përkundrazi, njëri nga fëmijët e subjektit ishte punësuar tashmë, ndërsa tjetri ishte ende në proces studimesh. Me fjalë të tjera, subjekti dhe personat e lidhur kishin të ardhura shtesë, që do të bënte të besueshëm nga viti 2013, ruajtjen “e ngrirë” të shumës së kursimeve të akumuluar. Nga ana tjetër, subjekti dhe personi i lidhur për herë të parë edhe shtojnë gjendjen e kursimeve vetëm me të ardhurat e vitit 2015, pasi subjekti u bë me dije gjatë kontrollit në ILDKPKI për faktin që nuk ka deklaruar shtesa e pakësime ndër vite.

**19.29.** Trupi gjykues vëren se si pasojë e kontradiktave të konstatuara në lidhje me vlerën e likuiditetit *cash* në datën 31.12.2014 dhe mënyrës së deklaramit të gjendjes së kursimit *cash* në datën 31.12.2015, të zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit – referuar deklaramimeve të tij në ILDKPKI [sipas paragrafit 19.24 më sipër], si dhe deklaramimeve para Kolegjit<sup>33</sup>, krijohen mospërputhje të mëtejshme për sa u përket vlerave të përdorimit të kursimit *cash* për vitin 2015. Në konkluzionet përfundimtare në Kolegj, referuar anekseve bashkëlidhur konkluzioneve përfundimtare, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar<sup>34</sup> në fakt një situatë të ndryshme e të re, sipas së cilës ka pasur pakësime në vitin 2011 dhe 2015, ndërsa sipas aktit të ekspertimit financiar të depozituar me parashtrimet në datën 18.09.2023, pakësimet janë në vlera të tjera dhe përfshijnë edhe vitet 2012 dhe 2014<sup>35</sup>. Deklaramimet e sipërcituara të subjektit të rivlerësimit nuk mbështeten as nga të dhënat e tabelës së të ardhurave, shpenzimeve dhe kursimeve, vit pas viti në periudhën 2003-2014, të përgatitura nga subjekti i rivlerësimit dhe të depozituara në ILDKPKI, në “Shpjegimet shtesë” të datës 28.03.2016, ku vihet re se kursimet e tij kanë pësuar ndryshime në çdo vit, duke u shtuar në vitet

---

<sup>32</sup> Sipas subjektit, në konkluzionet përfundimtare të datës 26.09.2023: “[...] Burimi i të gjitha depozitimeve të listuara nga Komisioneri Publik janë nga gjendja *cash* në vlerë 5.000.000 lekë, e deklaruar në vitin 2003 dhe e pandryshuar deri në vitin 2009, e cila është përdorur në periudhën e viteve 2009-2014 për të përballuar shpenzimet për shkollimin e fëmijëve, të cilat kompensoheshin në muajt në vazhdim të viteve përkatëse me të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes dhe pas vitit 2013, edhe paga e djalit K.”.

<sup>33</sup> Shih konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, datë 26.09.2023, parag. 10.1.1.2, faqe 23.

<sup>34</sup> Shih paragrafin 10.3.2. (ii), faqe 28-29 të konkluzioneve përfundimtare, datë 26.09.2023, të dorëzuara në Kolegj. Sipas këtij versioni, kursimi *cash* është pakësuar me 720.000 lekë në vitin 2011, me 1.780.000 lekë në vitin 2013, me 0 lekë në vitin 2014 dhe 1.500.000 lekë në vitin 2015.

<sup>35</sup> Aktit të ekspertimit ekonomiko-financiar, datë 10.12.2022, të depozituar nga subjekti, së bashku me parashtrimet e tij në Kolegj më datë 18.09.2023, kursimi *cash* është pakësuar me 450.000 lekë në vitin 2011, me 270.000 lekë në vitin 2012, me 0 lekë në vitin 2013, me 1.780.000 lekë në vitin 2014 dhe me 1.500.000 lekë në vitin 2015.

2004, 2005, 2007, 2008 dhe 2009, ndërkohë që janë pakësuar në vitet 2006, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014. Referuar kësaj tablele për periudhën 2010-2014, kursimet e subjektit të rivlerësimit janë pakësuar me 5.275.273 lekë, ndonëse gjendja e kursimeve më 31.12.2014, deklarohet në vlerën e 4.870.217 lekëve.

**19.30.** Në vlerësim të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues i gjeti jobindëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se depozitimet ndër vite të *cash*-it kanë pasur si burim kursimet në likuiditete jashtë sistemit bankar, në vlerë 5.000.000 lekë, e deklaruar në deklaratën për herë të parë në vitin 2004, e të cilat kanë qëndruar të pandryshuara deri në vitin 2014, në saje të zëvendësimit të tyre deri në fund të vitit përkatës me të ardhura familjare. Ky konkluzion mban në konsideratë, ndër të tjera, deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit brenda një periudhe të shkurtër [në mars dhe prill 2016], lidhur me vlerën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, lidhur me periudhën 31.12.2003 deri më 31.12.2014, sipas të cilave subjekti ka dhënë respektivisht vlerë zero (0) lekë deri më 31.12.2014 dhe me shtesën e shpjegimeve, ka referuar vlerën 2.500.000 lekë.

**19.31.** Deklarimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, të cilat rezultojnë të ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigjet e pyetësorëve të Komisionit, si dhe deklarimeve të dhëna para Kolegjit në parashtrësat e tij të datës 18.09.2023, kundrejt vlerave financiare të përdorura për depozitimet e kryera për pagesat e shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve sipas aktit të ekspertimit ekonomiko-financiar, të përgatitur më datë 10.12.2022, nga audituesi ligjor i angazhuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, bazuar mbi shpjegimet e dhëna prej atij vetë [subjektit], për sa u përket pasqyrave të fluksit të mjeteve monetare për periudhën e viteve 2009, 2010, 2012, 2013 dhe 2014.

**19.32.** Dinamika e kryerjes së pagesave bankare nëpërmjet depozitimit të *cash*-it në bankë, në secilin prej momenteve të analizuara, edhe në vlera të konsiderueshme, u vlerësua nga trupi gjykues si një faktor shtesë që zbeh besueshmërinë e pretendimeve të ngritura prej tij për ruajtje vlerash të konsiderueshme monetare jashtë sistemit bankar, të paprekura për nga vlera totale, për një periudhë kohore rreth 11-vjeçare dhe, pavarësisht ndryshimit të nevojave financiare familjare në rritje, që përfshinin tashmë edhe financimin e shkollimit të dy fëmijëve në institucione arsimore jashtë Shqipërisë. Fakti që këto vlera, në mars 2016 deklarohen të kenë qenë shpenzuar deri më 31 dhjetor 2014, për t'u rideklaruar në vlerën 2.500.000 lekë, disa javë më pas, për efekt të kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja, përforcon më tej bindjen e trupit gjykues që subjekti është kontradiktor dhe ka treguar mungesë transparence.

**19.33.** Nën dritën e analizës së mësipërme, trupi gjykues arriti në konkluzionin se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për përdorimin e kursimeve gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, nuk janë bindëse. Për rrjedhojë, për shkak të mospërputhjeve të konstatuara gjatë kontrollit, pretendimet e subjektit të rivlerësimit u çmuan të pabesueshme. Sikurse referuar edhe më sipër, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, pasi vlerësoi depozitimet e *cash*-it në sistemin bankar, të kryera për qëllimin e pagesave të shkollimit të djemve të subjektit të rivlerësimit [renditur më sipër në paragrafin 19.4 dhe në poshtëshënimin nr. 22], të analizuara në momentin e kryerjes së tyre, dhe

nën dritën e arsytimit të shtjelluar më sipër për zëra të caktuar të analizës financiare, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të *nuk* mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet e kryera për shkollimin jashtë vendit të dy djemve të subjektit të rivlerësimit. Balanca negative e përfutur nga kontrolli i analizës së Komisionit, kryer në Kolegji, rezultoi në një vlerë prej (-) 4.527.325 lekësh.

**19.34.** Në përfundim, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar në fakte dhe në ligj pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, sa u takon depozitimeve *cash* të kryera në sistemin bankar në funksion të mbulimit të shpenzimeve të shkollimit të dy djemve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për rrjedhojë, lidhur me këto shpenzime, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**20.** *Shkaku i ankimit që lidhet me apartamentin në Tiranë*<sup>36</sup>

**20.1.** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* këtë pasuri me të dhënat përkatëse, me çmim 48.346 USD, blerë me kredi për strehim nga Banka e Kursimeve në shumën 5.000.000 lekë, me kontratën e sipërmarrjes së vitit 2003 dhe të shitjes më datë 01.11.2014. Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, pasi ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit në përgjigje të barrës së provës lidhur me përfitimin e kredisë në kushte lehtësuese, sikurse edhe me burimet e krijimit të pasurisë, Komisioni ka konkluduar se nuk ka rrethana penalizuese dhe nuk ka shtuar burim të ri për krijimin e kësaj pasurie.

**20.2.** Në ankimin e tij, Komisioneri Publik e kundërshtoi si të pabazuar vlerësimin e Komisionit lidhur me këtë pasuri të paluajtshme, duke argumentuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë, referuar nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe ka përfutur kredinë lehtësuese jashtë kriterëve të përcaktuara ligjore. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, deklarimi për herë të parë gjatë procesit të hetimit administrativ për përdorimin edhe të të ardhurave nga paga dhe shitja e një pasurie në Shkodër kundrejt pagesës së një detyrimi në shumën 7.346 USD, nuk rezultoi i mbështetur në prova, pasi ky burim nuk ka gjetur pasqyrim në deklaratën *vetting* apo në deklaratën periodike vjetore. Në bisedimet përfundimtare, Komisioneri Publik argumentoi se çështja e përfitimit të kredisë në kushte lehtësuese mori përgjigje nga hetimi i kryer nga Kolegji. Shpjegimet e subjektit për deklarim real të gjendjes së tij të strehimit kundrejt detyrimeve që përcaktonte akti nënligjor i kohës [Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 102/1999, në vijim “VKM nr. 102/1999”], janë të drejta e të bazuara.

**20.3.** Në parashtrimet e tij para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi të dyja këto aspekte të shkakut ankimor që lidhen me pasurinë e paluajtshme objekt analize. Për të provuar nevojën e tij për strehim, njohur dhe deklaruar në Prokurorinë e Përgjithshme, subjekti i rivlerësimit paraqiti në cilësinë e provës një shkresë të Drejtorisë së Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të Prokurorisë së Përgjithshme [nr. {\*\*\*} prot., datë

---

<sup>36</sup> Me sipërfaqe 105,1 m<sup>2</sup>, në rr. “{\*\*\*}”.

13.09.2023], me anë të së cilës përcillej një kopje e deklaratës së tij konfidenciale për deklarin e pasurisë në vitin 1996, në zbatim të ligjit nr. 7903, datë 08.03.1995, ku evidentohet gjendja e strehimit të tij e deklaruar në Prokurorinë e Përgjithshme.

**20.4.** Subjekti po ashtu argumentoi që sipas aktit nënligjor në fjalë, lista e përfituesve miratohej nga kryeministri, ndërsa përfituesit nuk legjitimoheshin për të bërë kërkesë për përfitim kredie. Komisioneri Publik i është referuar gabimisht ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë” në ngritjen e këtij shkaku ankimor. Neni 6 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102/1999 ka hequr kushtet/kriteret për vlerën e kreditimit në varësi të gjendjes së strehimit dhe e ka lënë (vlerën e kreditimit) në përputhje me vullnetin e funksionarit përfitues të kredisë, të shprehur në kërkesën e paraqitur prej tij.

**20.5.** Për sa i përket shkakut të ankimit që lidhet me saktësinë e deklarin të burimeve të krijimit të pasurisë objekt kontrolli, subjekti i rivlerësimit argumentoi po ashtu se pretendimi i Komisionerit Publik është i pabazuar. Situata faktike e parashtruar nga Komisioneri Publik në ankim, nuk përbën në thelb deklarin të pasaktë apo deklarin të pamjaftueshëm në kuptim të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në qëndrimin e tij para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit u shpreh se ka kryer deklarin të saktë në deklaratën periodike të vitit 2003 dhe në atë të pasurisë *vetting*, në të cilën kishte deklaruar kredinë në vlerën e 5.000.000 lekëve, si burimin kryesor të destinuar për blerjen e pasurisë së paluajtshme, dhe se kishte deklaruar gjithashtu vlerën 48.346 USD të pasurisë së porositur me kontratën e sipërmarrjes, datë 23.07.2003, si dhe përfundimisht blerjen e pasurisë me kontratën e shitblerjes, datë 01.11.2014. Në këtë të fundit, përfshihej vlera 7.346 USD e materialeve të ndërtimit, të blera në cilësinë e porositësit me ndërtuesin, që përbënte 15% të vlerës totale të kontratës së sipërmarrjes, vlerë e cila sipas tij ishte zbritur nga shuma totale prej 48.346 USD dhe ishte deklaruar e paguar nga ndërtuesi dhe investitori në kontratën e shitblerjes.

**20.6.** Trupi gjykues i Kolegjit mori në konsideratë qëndrimin e Komisionerit Publik në konkluzionet përfundimtare për përfitimin e kredisë në kushte lehtësuese, që në analizën e kryer pas hetimit të kryer në Kolegj, rezultoi në përputhje me aktet nënligjore të kohës. Për pasojë, arsyetimi në vijim nuk do të ndalet në mënyrë konkrete në këtë aspekt të shkakut ankimor. Për sa i përket shkakut tjetër ankimor, e konkretisht saktësisë së deklarin të burimeve të krijimit të pasurisë objekt analize, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti ka kryer deklarin të pasaktë në deklaratën *vetting* për burimet e krijimit. Pretendimi i Komisionerit Publik është i bazuar. Nga ana tjetër, ky konstatim, nën dritën e rrethanave konkrete, nuk ka një peshë që duhet të shoqërohet me dhënien e masës disiplinore. Në kushtet që vlera e pasurisë është deklaruar saktë, sikurse edhe nuk rezultoi që subjekti të ketë qenë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për përballimin e këstit të dytë të apartamentit, në vlerën 7.346 USD, konstatimi i pasaktësisë vlerësohet pa peshë në zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Arsyetimi mbi të cilin mbështetet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

**20.7.** Sikurse potencuar edhe nga Komisioneri Publik, nga aktet në fashikull rezulton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në rubrikën e dedikuar për përshkrimin e pasurisë dhe burimit të krijimit, detajet përkatëse dhe: “[...] Burimi i

krijimit, kredia për strehim në Bankën e Kursimeve në shumën 5.000.000 lekë, me afat shlyerjeje 25 vjet”. Në krah, në rubrikën e vlerës, subjekti ka deklaruar 48.346 (dyzet e tetë mijë e treqind e dyzetë e gjashtë) “USA Dollar”. Në deklaratën për herë të parë, depozituar në ILDKPKI në mars të vitit 2004, subjekti ka deklaruar të njëjtat detaje dhe të njëjtin burim: “Kredi për strehim në Bankën e Kursimeve, Dega Tiranë”.

**20.8.** Gjatë hetimit administrativ, pyetur nga Komisioni për pagesat e kryera kundrejt shlyerjes së çmimit të blerjes së apartamentit, si dhe burimin e krijimit të shumës 7.346 dollarë, i cili, referuar kontratës së sipërmarrjes, përfaqësonte këstin e dytë të çmimit të apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se me pëlqimin e dy palëve, në periudhën gusht 2003 deri në shtator 2005, ka blerë e dërguar në objektin e porositur, pjesë të materialeve të ndërtimit e pajisjeve të ndryshme, specifikuar prej tij, sikurse ka rakorduar me administratorin e firmës ndërtuese. Subjekti po ashtu është shprehur se: “[...] ka rezultuar se shpenzimet e kryera nga unë me blerjen e materialeve e pajisjeve për ndërtimin e apartamentit të porositur, janë të njëjta me vlerën e këstit të fundit prej 7346 USD [...]”. Burim krijimi i shumës 7.346 USD, sipas të njëjtave shpjegime të subjektit, janë referuar të ardhurat dhe kursimet familjare nga paga, deklaruar në deklaratat periodike vjetore 2003, 2004 e 2005 dhe “vlera 600.000 lekë, ose 1/5 e shumës së përfituar nga shitja në vlerën 3.200.000 lekë e pasurisë së trashëguar nga babai, me kontratën e shitjes me rezervë nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 24.11.2001, e deklaruar [...] në deklaratën e pasurisë për vitin 2003 [...]”. Të njëjtin qëndrim subjekti i rivlerësimit e mbajti edhe në parashtrimet e tij gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj.

**20.9.** Në shqyrtim të akteve të sipërreferuara dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë gjatë hetimit administrativ se për shlyerjen e detyrimeve, si burim krijimi i kësaj pasurie kanë shërbyer edhe të ardhura të tjera apo ato të përfituara nga apartamenti në Shkodër. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë në deklaratën e pasurisë *vetting*, burimet e krijimit të pasurisë së paluajtshme objekt kontrolli, pasi në këtë deklaratë nuk ka gjetur pasqyrim burimi i krijimit të vlerës prej 7.346 USD, që shërbeu për mbulimin e këstit të dytë të çmimit të apartamentit. Si e tillë, pavarësisht nga shpjegimet e subjektit për mënyrën se si u shlye ky detyrim, ai vlerësohet si pjesë integrale e vlerës totale monetare të shpenzuar për krijimin e kësaj pasurie. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues çmoi se ky fakt, nën dritën e rrethanave konkrete, sikurse përmbledhur më sipër, nuk ka një peshë që do të duhet të shoqërohej me dhënien e masës disiplinore. Kjo pasaktësi nuk rezulton të shoqërohet me mungesë burimesh, sikurse edhe vlera e pasurisë është deklaruar saktë. Për rrjedhojë, vlerësimi i Komisionit lidhur me kontrollin e kësaj pasurie të subjektit të rivlerësimit gjendet i drejtë dhe i bazuar.

- 21.** Në përfundim të gjykimit, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, nga kontrolli i ushtruar vendimit të Komisionit në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 33, pika 5, germat “a” dhe “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur me të. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit

të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, nuk është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 319, datë 03.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kujtim Luli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 06.10.2023, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi – kundër*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi – kundër*

**KRYESUESE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*



## MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtarët Ina Rama dhe Sokol Çomo, kemi votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për zgjidhjen e çështjes që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 319, datë 03.12.2020, vendim i cili ka shkarkuar subjektin e rivlerësimit nga detyra e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme. Bazuar në vlerësimin tonë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, kemi votuar për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.
2. Duke pranuar pjesërisht situatën faktike të konstatuar në vendimin e shumicës së trupit gjykues, do të ndalemi në ato fakte dhe rrethana të cilat, sipas pakicës, meritojnë një vlerësim të ndryshëm, i cili përcakton edhe qëndrimin tonë për votën kundër.
3. Subjekti i rivlerësimit Kujtim Luli u shkarkua nga detyra nga Kolegji mbështetur në konkluzionet që i përkasin kriterit të vlerësimit të pasurisë, duke konkluduar se ai nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur me të.
4. Në vlerësimin e shkakut të ngritur në ankim nga Komisioneri Publik se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me shpenzimet e shkollimit të dy djemve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i jemi bashkuar qëndrimit të shumicës lidhur me saktësinë dhe mbështesim arsyetimin e saj në vendim<sup>37</sup> lidhur me konkluzionin se, ndonëse konstatohet se deklarimet e subjektit të rivlerësimit para ILDKPKI-së për shpenzimet e shkollimit dhe jetesës së dy fëmijëve në ShBA, referuar deklaratave periodike të viteve 2014, 2015 dhe 2016, kanë qenë të paplota, këto deklarime jo në përputhje me urdhërimet e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, nuk kanë cenuar saktësinë e deklarimit të kryer në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë, për sa kohë këto shpenzime nuk përbënin detyrim për deklarim, referuar dispozitave kushtetuese, ligjore e nënligjore që normojnë mënyrën e deklarimit lidhur me këtë kriter vlerësimi.
5. Analiza në vijim e këtij shkakut ankimi nga pakica, fokusuar në verifikimin e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për përbalimin e këtyre shpenzimeve (të kryera nëpërmjet transfertave bankare me origjinë depozitimet e shumave *cash* në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të) dhe vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme, është e ndryshme nga ajo e shumicës, e cila, referuar arsyetimit të saj në vendim<sup>38</sup>, ka kryer një analizë mbi bazën e kontrollit të ligjshmërisë së depozitimeve të shumave *cash* në momentin e kryerjes së tyre, duke përfshirë në këtë analizë vetëm burimet e të ardhurave të vitit të krijimit të depozitimeve, me periudhë vlerësimi nga data 1 janar deri në datën e çeljes së depozitës, nisur nga premisa që mosdeklarimi nga subjekti i rivlerësimit i ndryshimeve, shtesave apo pakësimeve, të likuiditetit gjendje *cash* në banesë në deklaratat periodike për periudhën 2004-2014, përbën

<sup>37</sup> Shih paragrafët 18.7 e vijues të vendimit.

<sup>38</sup> Shih paragrafin 19.10 e vijues të vendimit.

fakt të mospërdorimit të këtij likuiditeti si burim për kryerjen e këtyre depozitave, si pretenduar nga Komisioneri Publik.

6. Në vlerësimin e pakicës, depozitimet objekt kontrolli<sup>39</sup>, referuar dinamikës së veprimeve të kryera me fondet e depozituara përgjatë vitit të depozitimit, provojnë më së miri faktin që këto shuma monetare janë depozituar në institucionet bankare në funksion të përmbushjes së qëllimit të vetëm, kryerjes së pagesave për mbulimin e shpenzimeve që i atribuohen shkollimit dhe jetesës së fëmijëve të subjektit të rivlerësimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas periudhave të evidentuara në vendim. Thënë kjo, në konsideratë edhe të faktit që referuar legjislacionit të zbatueshëm në kohën e kryerjes së këtyre depozitimeve, deklarimi i shpenzimeve të kryera (për vitet 2012 e në vazhdim) kufizohej vetëm në deklarimin e vlerës së shpenzimit të deklarueshëm dhe jo të burimit të përdorur<sup>40</sup>, pakica arrin në përfundimin që analiza e këtyre depozitimeve, si fonde të përdorura për mbulimin e shpenzimeve të shkollimit, duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi të të gjitha burimeve të të ardhurave të disponueshme të subjektit të rivlerësimit në momentin e kryerjes së tyre, duke përfshirë edhe gjendjet e kursimit *cash* në banesë. Në këtë arsyetim, pakica mban në konsideratë edhe qëllimin për të cilin subjektet mbajnë dhe deklarojnë kursime gjendje *cash* në banesë, i cili logjikisht ka të bëjë me disponueshmërinë dhe aftësinë për të përdorur pa vonesa dhe kufizime kohore dhe sasiore, kursimet e ligjshme të krijuara ndër vite dhe të deklaruar rregullisht, në përputhje me detyrimet ligjore përkatëse.
7. Në këtë kontekst, pakica vlerësoi të verifikojë mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve të kryera për shkollimin dhe jetesën e dy fëmijëve të subjektit të rivlerësimit jashtë vendit, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit se në përballimin e këtyre shpenzimeve, ai kishte përdorur edhe kursimet gjendje *cash* në banesë, të cilat i kishte rikuperuar në periudhat pasardhëse të vitit, me të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, si dhe të ardhurat e punësimit të djalit të madh. Këtë analizë pakica e kreu mbi premisën që kursimi gjendje *cash* i deklaruar në deklaratën për herë të parë, në vitin 2004, ishte në shumën 3.000.000 lekë dhe jo sikundër pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, në shumën 5.000.000 lekë, konkluzion ky i bazuar në analizën faktiko-juridike të paraqitur nga shumica në vendim, e cila mbështetet plotësisht nga ne gjyqtarët në pakicë<sup>41</sup>. Gjithashtu, në deklarimet e kursimeve *cash* në banesë, u mbajtën në konsideratë, në cilësinë e akteve provuese sipas parashikimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike para ILDKPKI-së, për periudhën 2004-2016, nga ku rezultoi që përveç gjendjes së likuiditetit *cash* të deklaruar në deklaratën për herë të parë në vitin 2004, si dhe në deklaratat periodike deri në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjë ndryshim të gjendjes së kursimeve *cash* në banesë.

---

<sup>39</sup> Referoju të dhënave të këtyre depozitimeve në paragrafin 19.4 të vendimit dhe poshtëshënimit nr. 22.

<sup>40</sup> Shih nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, parashikimet e të cilit lidhur me shpenzimet e deklarueshme të përcaktuara në paragrafin 1, shkronja "h", janë pasqyruar në faqen 6 të deklaratës periodike, në rubrikën "Shpenzime të deklarueshme/të dhëna konfidenciale". Në këtë rubrikë të formularit të deklarimit, vihet re se objekti i deklarimit përcaktohet nëpërmjet kërkesës për të paraqitur me hollësi çdo lloj shpenzimi të deklarueshëm me vlerë mbi një shumë, sipas kufirit të përcaktuar në ligj, si për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim e të tjera të këtij lloji, të kryera nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit.

<sup>41</sup> Shih paragrafët 19.18 - 19.22 të vendimit.

8. Në vijim të sa më sipër, nga analiza e kryer në Kolegj nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, rezultoi se për mbulimin e shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012 dhe njëkohësisht për të rikuperuar shumën e likuiditetit gjendje *cash* në banesë, prej 3.000.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën fillestare në vitin 2004, të pretenduar si të përdorur në momentet e kryerjes së depozitimeve bankare, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme, respektivisht në shumat 138.631 lekë, 318.597 lekë, 433.810 lekë dhe 260.844 lekë, në total në shumën 1.151.882 lekë. Në kuptim të kësaj analize, pakica çmon se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për ruajtjen të pandryshuar të pasurisë së llojit likuiditet në gjendje *cash* në banesë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
9. Duke u shprehur dakord me qëndrimet e mbajtura nga shumica për çështjet e tjera, në përfundim kemi vlerësuar se mungesa e burimeve të ligjshme në shumën prej 1.151.882 lekësh, për shkak të mbajtjes së pandryshuar të gjendjes së likuiditetit *cash*, të deklaruar në deklaratën për herë të parë në vitin 2004, si dhe në deklaratat periodike deri në vitin 2014, krahas problematikave të konstatuara lidhur me saktësinë e deklarimeve, nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk duhet konsideruar se e vë subjektin në kushtet e mosarritjes së një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë të sa më sipër analizuar, shkarkimi i subjektit të rivlerësimit nga detyra, për ne gjyqtarët në pakicë nuk gjendet i drejtë.
10. Për të gjitha sa trajtuar më lart, kemi votuar për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Kujtim Luli.

**GJYQTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*